



INSTITUTI KOSOVAR PËR KËRKIME DHE ZHVILLIM TË POLITIKAVE

Seria e punimeve politike 2012/03

# QASJET BAZË PËR PAJTIMIN NDËR-ETNIK NË PJESËN VERIORE TË KOSOVËS

Prishtinë, shkurt 2012

Përgatitur nga: Judith Brand dhe Valdete Idrizi  
Edituar nga: Shpend Kursani dhe Ilir Deda

E drejta autoriale © 2012 e KIPRED-it. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit. Ju lutem kontaktoni [info@kipred.net](mailto:info@kipred.net) apo +381 38 227 778.

Publikuar nga



Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave  
Rr. Rexhep Mala, Nr. 5A  
10 000 Prishtinë, Kosovë  
Telefoni dhe Faksi: +381 38 227 778  
[www.kipred.net](http://www.kipred.net)

## Përmbajtja

1.	Hyrje.....	4
1.1.	Metodat e hulumtimit.....	5
2.	Konteksti i Pjesës Veriore të Kosovës .....	5
2.1.	Komunitetet.....	5
2.2.	Aspektet socio-ekonomike .....	7
2.3.	Ndarja institucionale dhe politike.....	8
2.4.	Barrikadat.....	8
3.	Përmbledhje e marrëdhënieve ndëretnike.....	9
3.1.	Linjat gjeografike të ndarjes.....	9
3.2.	Motivimi për kontakt përtej linjave.....	10
3.3.	Biznesi .....	11
3.4.	Organizatat e shoqërisë civile.....	12
3.5.	Marrëdhëniet në mes të komuniteteve të ndryshme.....	13
4.	Sfidat dhe qasjet.....	14
4.1.	Politikat .....	14
4.2.	Presioni brenda komunitetit.....	17
4.3.	Zona jote – Zona ime – Zona e përzier.....	21
4.4.	Më shumë se përkatësi etnike.....	26
5.	Përfundimi.....	29
5.1.	Përmirësim i kufizuar .....	29
5.2.	Interesi reciprok si motivim .....	30
5.3.	Marrëdhëniet personale – jo politikës.....	31
5.4.	Nga marrëdhënia në besim qytetar.....	31
5.5.	Çështjet e paadresuara nga e kaluara.....	32
5.6.	Qasja multidimensionale.....	32
6.	Rekomandimet.....	33
	Burimet .....	36

## 1. Hyrje

Mitrovica<sup>1</sup> dhe pjesa veriore e Kosovës është e karakterizuar nga situata të tensionuara, të ndjeshme dhe të paqëndrueshme; dhe ndonjëherë, me shpërthime të dhunës. Ky zonë zakonisht tërheqë vëmendjen vendore dhe ndërkombëtare kryesisht përmes lajmeve negative: barrikatadat, ndarjet etnike, ndarjet sociale dhe institucionale, djegia dhe demolimi i zyrave të doganës, dhuna e motivuar etnikisht, mungesa e sundimit të ligjit, bizneset ilegale të cilat nuk njohin dallimet etnike, janë vetëm disa prej tyre. Posaçërisht Mitrovica, qyteti i ndarë të lumi Ibër ka qenë një pikë e nxehtë e tensioneve ndëretnike dhe është bërë sinonim i konfliktit të pazgjidhur në pjesën veriore të Kosovës.

Fokusi i këtij punimi është të marrëdhëniet në mes të komuniteteve të shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës, jo vetëm për shkak se këto janë dy komunitetet më të mëdha në vend, por gjithashtu se janë edhe më të armiqësuarat. Ky punim thekson sfidat kryesore në bashkëpunimin ndëretnik dhe qasjet e ndërmarra nga Organizatat Jo-Qeveritare (OJQ) dhe sektori i biznesit në adresimin e tyre. Këta dy sektorë janë objektet kryesore të analizave në nivelin bazë për pajtim ndëretnik në pjesën veriore të Kosovës.

Pajtimi definohet gjerësisht si një proces i cili përfshinë edhe qasjen nga poshtë-lartë edhe atë nga lartë poshtë, - nivelin dhe institucionet bazë - që ka për qëllim rikthimin e marrëdhënieve në mes të njerëzve, komuniteteve, si dhe në mes të institucioneve dhe qytetarëve dhe në krijimin e besimit qytetar<sup>2</sup>. Organizatave bazë iu është dhënë një rëndësi e madhe si akterë kryesor në procesin e pajtimit; sidoqoftë, sado që janë të angazhuara aktivisht në bashkëpunimin ndëretnik, ato nuk mund të kenë ndikim shoqëror, nëse proceset e larta politike nuk i përkrahin përpjekjet për pajtim ose janë në kundërshtim me të.

Ndikimi i politikës mbi mundësitë e bashkëpunimit ndëretnik është vlerësuar përgjithësisht shumë i lartë; shumica e personave të intervistuar përcjellin politikën “jo-politike”, duke mos diskutuar asgjë që mund të jetë e ndërlikuar me politikë, në mënyrë që të jenë në gjendje të krijojnë kontakte ndëretnike në rend të parë. Në kohën e hulumtimit dhe shkrimit të punimit (tetor 2011 – janar 2012), serbët e Kosovës kishin vendosur barrikada si shenjë proteste ndaj përpjekjeve të institucioneve të Kosovës për të ushtruar autoritetin në pjesën veriore të Kosovës. OJQ-të në disa raste kishin përshtatur aktivitetet e tyre ndaj kësaj situatë, por në përgjithësi kishin vazhduar të punojnë “përtej linjave etnike”, përdërisa ndikimi i barrikadave është ndier shumë brenda sektorëve të biznesit dhe tregtisë. Paragjykimet, shpesh të krijuara dhe/ose të forcuara nga mediat, janë identifikuar si pengesa kryesore për kontaktin ndëretnik. Nga frika dhe mosbesimi, shumë anëtar të komuniteteve të ndryshme e kufizojnë vetën që të lëvizin vetëm brenda “zonave të tyre” dhe nuk kalojnë në “zonën e të tjerëve”. Për këtë lagjet e përzierra marrin një rëndësi të madhe si pika (potenciale) të takimit për komunitete të ndryshme. Strategjia kryesore e aplikuar nga organizata joqeveritare (OJQ-të) për të tejkaluar paragjykimet është themelimi i marrëdhënieve të drejtpërdrejta. Aktivitetet ndëretnike që kanë për qëllim vetëm

---

<sup>1</sup> Emrat e vendeve janë të shkruar në gjuhën shqipe dhe serbe, përveç nëse nuk ka dallim në të dy gjuhët, sipas standardeve të OSBE-së. Radhitja e gjuhëve/shkrimit varet nga gjuha që përdoret kryesisht në atë vend, p.sh. Prishtinë/Priština, si një qytet me shumicë shqiptare të Kosovës, emri në gjuhën shqipe shkruhet i pari, përdërisa për Zvečan/Zveçan, me shumicë serbe të Kosovës, emri në gjuhën serbe është i pari.

<sup>2</sup> De Greiff ka zhvilluar ‘modelin e besimit qytetar’, përmes të cilit ai definon pajtimin si “kusht nën të cilin qytetarët mund t’i besojnë njëri-tjetrit përsëri ose nga fillimi. Kjo do të thotë se ata janë mjaftë të zotuar për normat dhe vlerat që motivojnë institucionet udhëheqëse, kanë mjaftë besim se ata që operojnë me këto institucione e bëjnë këtë gjithashtu mbi bazat e atyre normave dhe vlerave, dhe janë mjaftë të sigurt për zotimet e bashkëqytetareve të tyre për t’iu përmbajtur këtyre normave dhe vlerave themelore” De Greiff 2008, f. 126f

mbledhjen e njerëzve për hir të kontaktit ndëretnik pa qenë të bazuara në nevojat, brengat dhe interesat e vërteta kritikohen fuqishëm. Në këtë drejtim, tregtisë dhe biznesit i jepet një rol kyç në rikthimin e marrëdhënieve në mes të komuniteteve pasi që ato janë të bazuara ekskluzivisht në interesin e përbashkët.

Ka një mori të gjerë të aktiviteteve të ndryshme, por edhe një seri të gjerë të qasjeve të ndryshme që aplikohen në bashkëpunimin ndëretnik. Kryesisht niveli bazë është i angazhuar në (ri)themelimin e marrëdhënieve në mes të komuniteteve, shpesh përmes kontakteve personale në mes të anëtarëve të komuniteteve të ndryshme dhe duke ofruar aktivitete të përbashkëta. Disa OJQ kanë zgjedhur një qasje më të indirekte në implementimin e projekteve në dy lokacione të ndryshme, me kontakte të përpikta. Një qasje tjetër që ushtrohet nga OJQ-të është fokusimi në punët ndër-komuniteteve si parakusht për bashkëpunimin e ardhshëm ndëretnik. Llojllojshmëria e qasjeve është një pasurim, jo konkurrencë, por ka nevojë për koordinimin respektivisht marrëveshje për një qëllim të përbashkët gjithëpërfshirës.

Komunikimi ndëretnik është përmirësuar gjatë viteve të fundit dhe është një indikator inkurajues që organizatat kanë vazhduar aktivitetet e përbashkëta përkundër barrikadave, edhe pse kontaktet biznesore dhe kontaktet tjera të vetë-iniciuara kishin rënë gjatë kësaj kohe. Sidoqoftë, përderisa situata politike në pjesën veriore të Kosovës nuk zgjidhet dhe nëse niveli institucional nuk përkrahë përpjekjet në nivelin bazë, çfarëdo procesi i pajtimit ngec dhe marrëdhëniet në mes të komuniteteve mbasin të brishta. Çështjet e rëndësishme siç janë kthimi, ballafaqimi me të kaluarën ose njohja e viktimave nuk mund të adresohen vetëm nga niveli bazë. Themelimi i marrëdhënieve, ushqimi i kontakteve dhe komunikimit ndëretnik, largimi i paragjytimeve janë fokusi kryesor i organizatave bazë, si dhe angazhimi në punët ndër-komuniteteve për më shumë diversitet.

### **1.1. Metodat e hulumtimit**

Ky hulumtim vështron vetëm qasjet e nivelit bazë për pajtimin ndëretnik në pjesën veriore të Kosovës. Fokusimi është në bashkëpunimin ndëretnik dhe komunikimin në mes të komuniteteve të ndryshme, pasi që vlerësohet se kjo është pika fillestare për çfarëdo procesi të pajtimit.

Studimi është i bazuar në hulumtime nga tavolina si dhe intervista të drejtpërdrejta, përfshi grumbuj shumë të ndryshëm të akterëve në mënyrë që të krijohet një pasqyrë më e gjerë. Në total, janë bërë intervista me 35 persona, partnerët e intervistave përfshijnë: shqiptarë të Kosovës (17), serb të Kosovës (10), përfaqësues të romëve (1), boshnjakëve (1) dhe turqve (2). Shumica e partnerëve të intervistave nga sektori i shoqërisë civile e kanë bazën në Mitrovicë jugore dhe veriore. Kjo gjithashtu reflekton situatën në teren: Mitrovica është vendi ku shumica e aktiviteteve të shoqërisë civile kryhen, ku shumica e aktiviteteve ndëretnike implementohen, dhe nëpër të cilin kalon linja e ndarjes. Aktivitetet që kanë të bëjnë me shoqërinë civile dhe biznesin ishin fokusi kryesor i hulumtimit.

## **2. Konteksti i Pjesës Veriore të Kosovës**

### **2.1. Komunitetet**

Pjesa veriore e Kosovës përfshin tri komuna: Zubin Potok, Zvečan, Leposaviq dhe komunën e Mitrovicës<sup>3</sup>. Qyteti i Mitrovicës është i ndarë përmes lumit Ibër i cili gjithashtu

---

<sup>3</sup> Administrimi i Mitrovicës është kompleks, me tri autoritete konkurruese: plani i Ahtisaarit parashikon një ndarje të komunës së Mitrovicës siç ka qenë para vitit 2008, në dy komuna: Mitrovicë Jugore dhe Mitrovicë Veriore. Kjo nuk është implementuar ende. Mitrovica Jugore vepron si komunë sipas ligjit të Kosovës, me pjesën veriore të Mitrovicës formalisht nën të njëjtin juridiksion përderisa komuna e re të

shënon linjën e qartë të ndarjes në mes të popullatës shumicë shqiptare të Kosovës, në jug të lumit, dhe popullatës shumicë serbe të Kosovës në veri të lumit<sup>4</sup>. Pasi që nuk ka pasur regjistrim të besueshëm që nga viti 1981 për tërë zonën, shifrat demografike janë të bazuara në vlerësime. Sipas vlerësimeve të përdorura nga KFOR-i, Policia e Kosovës, institucionet e Kosovës dhe prezenca ndërkombëtare në Kosovë, ka rreth 120,000 – 130,000 banorë në katër komunat. Janë përafërsisht 75,000-80,000 shqiptarë të Kosovës dhe 40,000 serb të Kosovës përfshi 10,000 boshnjak, turq dhe komunitetet RAE që jetojnë në këtë zonë, shumica e të cilëve – 7,000 – jetojnë në veri të lumit<sup>5</sup>. Për shkak të luftës në vitet 1998/99, anëtarët e komuniteteve respektive jo-shumicë ishin detyruar të largohen, kanë ikur, janë zhvendosur ose kanë migruar. Gjatë trazirave të vitit 2004, shumë serb që jetonin në pjesë tjera të Kosovës janë zhvendosur dhe kanë kaluar në pjesën veriore të Kosovës.

Procesi i kthimi në pjesën veriore të Kosovës është shumë i ngadalshëm. Jo vetëm që popullata origjinale është zhvendosur – serbët e Kosovës që dikur jetonin në pjesën jugore të Mitrovicës tash jetojnë në pjesën veriore, boshnjakët dhe shqiptarët e Kosovës të cilët dikur jetonin në pjesën veriore të Mitrovicës tash jetojnë në pjesën jugore – por gjithashtu ka serb të zhvendosur brenda (PZhB) nga pjesët tjera të Kosovës kanë lëvizur drejt pjesës veriore të Kosovës<sup>6</sup>. Me ardhjen e studentëve dhe profesorëve në Mitrovicën veriore, kjo pjesë e qytetit është bërë qendra urbane për serbët në Kosovë dhe ka ndryshuar thellësisht karakterin e tij në dekadën e fundit, teknikisht duke shërbyer si “kryeqytet serb” për serbët e Kosovës. Mitrovica veriore është nikoqire e universitetit të ri të ndërtuar, të zhvendosur nga Prishtina, teatrin, gjithashtu të zhvendosur nga Prishtina, si dhe spitalin e madh, të pajisur plotësisht si dhe institucione tjera.

Edhe pse janë shumicë, shqiptarët dhe serbët e Kosovës nuk janë komunitetet e vetme që jetojnë në pjesën veriore të Kosovës. Mitrovica njëherë ishte njëri prej vendbanimeve më të mëdha për romët në zonë me rreth 8,000<sup>7</sup> romë që jetonin në vendbanim kompakt, “mëhallën e romëve”, që në jug të Ibrit. Pas shkatërrimit total të vendbanimit gjatë luftës dhe ikjes së gjithë popullatës rome, kthimi ka filluar vetëm në vitin 2007. Shumica e romëve të cilët ishin vendosur në disa kampe në Mitrovicën veriore, janë kthyer në ndërtesat e rindërtuara në “mëhallën e romëve” në pjesën jugore. Tash diku rreth 1,230<sup>8</sup> romë jetojnë

---

mos krijohet. Ky juridiksion de facto ekziston vetëm në letër. Që nga viti 2002, Administrata e UNMIK-ut në Mitrovicë (AUM) vepron si autoritet qeverisës në atë pjesë të qytetit, e financuar përmes buxhetit të Kosovës. Pushteti i AUM sfidohet nga një autoritet tjetër në Mitrovicë/Mitrovica veriore: strukturat paralele komunale serbe të cilat veprojnë sipas Ligjit të Serbisë dhe janë themeluar në vitin 2008 pas zgjedhjeve të organizuara nga Serbia në Kosovë duke shkelur RKSKB 1244. Shiko gjithashtu: IKS 2009, f.6ff

<sup>4</sup> Për një përmbledhje të detajuar dhe gjithëpërfshirëse për komunitetet e Kosovës shiko Profili i Komuniteteve i OSBE-së, OSBE 2011

<sup>5</sup> Sipas vlerësimeve të OSBE-së, të katër komunat së bashku kanë një popullsi prej përafërsisht 180,000 banorëve, prej të cilëve shumica, 115 000, janë shqiptarë të Kosovës, që jetojnë kryesisht në Mitrovicën jugore (110,000). Përafërsisht 66,000 serb të Kosovës jetojnë në katër komunat, në të gjitha vendet përveç në pjesën jugore të komunës së Mitrovicës. Përafërsisht 7,000 anëtar të komuniteteve jo-serbe jetojnë në Pjesën veriore të Kosovës, dhe rreth 3,000 jo-shqiptarë në pjesën jugore të Mitrovicës.

<sup>6</sup> Sipas statistikave të UNHCR, në vitin 2010 zonë i Mitrovicës kishte 14.585 PZhB, nga totali prej 18.258 PZhB në gjithë Kosovën, 6957 janë PZhB serb, 7.317 shqiptar dhe 262 romë, ashkali, egjiptian. Shiko: UNHCR 2011, f.3

<sup>7</sup> Shënimet demografike të marra nga profilet komunale të OSBE-së 2009, dhe Harta Etno-Politike e ECMI

<sup>8</sup> Shiko OSBE Profilet e Komuniteteve, OSBE 2011, f.214

në Mitrovicë. Komuniteti i ashkalinjëve numëron rreth 425 anëtar që jetojnë në Mitrovicën jugore, kryesisht në lagjen Dy Korriku.<sup>9</sup>

Shumica e anëtarëve të komunitetit turk, rreth 1,900 persona<sup>10</sup>, jetojnë në pjesën jugore të Mitrovicës. Komuniteti boshnjak prej rreth 6,000 anëtarëve para luftës, sot numëron rreth 1,500 anëtar në komunën e Mitrovicës. Shumica, 1,000, jetojnë në Mitrovicën veriore, prej të cilëve afër 300 në mëhallën e boshnjakëve<sup>11</sup>, dhe rreth 500 në pjesën jugore. Rreth 300-500 boshnjak jetojnë në komunën e Leposaviqit, kryesisht në dy fshatra, Rvatska dhe Berberishtë. Lagja e Boshnjakëve është njëra prej lagjeve të përziera në Mitrovicën veriore, me disa komunitet që jetojnë aty. Lagjet tjera të përziera në Mitrovicë janë Kodra e Minatorëve, Kroi i Vitakut, Suhodolli dhe lagje tjera më të vogla.

Shqiptarët në pjesën veriore të Kosovës jetojnë në lagjet e përziera etnike të përmendura më lartë në Mitrovicën veriore, ose në fshatrat mono-etnike në tri komunat tjera. Zubin Potoku ka një fshat me shqiptar të Kosovës, Çabër me përafërsisht 1,000 banorë<sup>12</sup>. Në komunën e Zveçanit janë tri fshatra shqiptare, Boletin, Lipë dhe Zhazhë me rreth 400 banorë gjithsej<sup>13</sup>. Përafërsisht 300 shqiptarë të Kosovës<sup>14</sup> jetojnë në tri fshatra të komunës së Leposaviqit, Koshtovë, Bistricë e Shalës dhe Cerajë. Në të gjitha rastet, vetëm një pjesë e banorëve të para-luftës, janë kthyer deri më tani.

## 2.2. Aspektet socio-ekonomike

Mitrovica mbahet mend si një zonë industriale, vendi i një prej komplekseve më të mëdha industriale në ish-Jugosllavi, kompleksi i minierës së Trepça. Vetëm një fraksion i 22,000 punëtorëve të dikurshëm janë të punësuar sot<sup>15</sup>. Që nga viti 1999, norma e papunësisë në pjesën veriore të Kosovës është dukshëm më e lartë se sa mesatarja e Kosovës<sup>16</sup>; kjo i prek të gjitha komunitetet. Pjesa veriore e Kosovës është goditur rëndë nga de-industrializmi dhe konflikti i pazgjidhur etnik. Nuk është çudi që situata ekonomike dhe shkalla e lartë e papunësisë perceptohen si probleme kryesore, pa marrë parasysh prejardhjen etnike<sup>17</sup>. Në Mitrovicën jugore, aktivitetet kryesore ekonomike janë të organizuara rreth sektorit privat me 95 përqind të bizneseve që kanë maksimum pesë punëtor, dhe pothuajse gjysma e tyre që merren me tregti dhe shitje me pakicë<sup>18</sup>. Sektori publik në pjesën veriore të Kosovës është i ndarë në institucione të Kosovës dhe ato të financuara nga qeveria e Serbisë, zakonisht të referuara si “struktura paralele”. Këto të fundit ofrojnë një numër të madh të

---

<sup>9</sup> Shiko OSBE Profilet e Komuniteteve, OSBE 2011, f.65

<sup>10</sup> OSBE 2011, f. 303

<sup>11</sup> Sipas përfaqësuesit të komunitetit të boshnjakëve në Mitrovicë: 1200 boshnjak në Mitrovicën veriore përfshi këtu lagjen e boshnjakëve, dhe 300 në Mitrovicën jugore; në komunën e Leposaviqit 800 – 1000 boshnjak kryesisht në dy fshatra; para luftës, 7.500 boshnjak jetonin në atë zonë. Shumica janë ndjekur nga pjesa jugore pas luftës të vitit 1999 ose kanë migruar në Serbi (Sanxhak) ose vende të treta. Intervista me 13 dhjetor 2011 në Mitrovicë

<sup>12</sup> Sipas vlerësimeve të komunitetit: 1.400 shqiptar të Kosovës. Intervistë me zyrtarin komunal nga komuna e Kosovës e Zubin Potokut, Çabër, 18 tetor 2011

<sup>13</sup> OSBE 2011, f. 35; Vlerësimet e zyrtarëve komunal shkojnë nga 600 deri 800 banorë; Intervista me zyrtarin komunal nga komuna e Kosovës e Zveçanit, me 24 tetor 2011

<sup>14</sup> OSBE 2011, f. 35

<sup>15</sup> Shiko Palairt 2003, f. 8; IKS 2009, f. 16

<sup>16</sup> Shiko IKS 2009, f. 14

<sup>17</sup> Shiko UNDP 2011, f. 15f

<sup>18</sup> Shiko IKS 2009, f. 15

vendeve të punës<sup>19</sup> dhe pagave me vlerë prej 150 përqind nga ato të paguara në Serbi për të njëjtën pozitë. Duke financuar institucionet serbe në Kosovë, qeveria e Serbisë mundohet të ushtroj ndikim dhe kontroll politik. Sektori privat është më pak i zhvilluar se sa në pjesën jugore<sup>20</sup>, dhe e kundërta, në Mitrovicën jugore, sektori publik nuk është aq i rëndësishëm në lidhje me punësimin si në pjesën veriore.

Pjesa veriore e Kosovës është kryesisht rurale<sup>21</sup>. Bujqësia është e pazhvilluar, edhe pse ofron një potencial të madh posaçërisht në fushat e pylltarisë dhe përpunimit të drurit që është një resurs i pakët në pjesët tjera të Kosovës<sup>22</sup>.

### 2.3. Ndarja institucionale dhe politike

Pjesa veriore e Kosovës e banuar kryesisht me serb, që nga qershori i vitit 1999, asnjëherë nuk ka qenë nën kontrollin e plotë efektiv të UNMIK-ut e edhe më pak të qeverisë së Kosovës. Në pjesën veriore të Kosovës, ndryshe nga pjesët tjera të Kosovës, deklarata e pavarësisë në vitin 2008 është përcjellë me protesta dhe përplasje të dhunshme. Për herë të parë, Serbia organizoi zgjedhjet lokale për serbët në Kosovë në vitin 2008, që është atribuuar kryesisht si një veprim i ndërmarrë nga Serbia si rezultat i deklaramit të pavarësisë. Serbia krijoi strukturat e veta komunale, të cilat vepronin sipas ligjit të Serbisë. Sidoqoftë, këto zgjedhje nuk janë njohur nga institucionet e Kosovës e as nga UNMIK-u, pasi që ato shkelnin RKS KB 1244. Për më shumë, këto komuna nuk njihen nga Kosova, as nga UNMIK-u e as misionet tjera ndërkombëtare në Kosovë. Përveç komunave, autoritetet e Serbisë kanë themeluar dhe vazhdojnë të përkrahin institucione tjera, të njohura si “institucione paralele” në pjesën veriore të Kosovës. Ato përfshijnë institucionet shëndetësore, sistemin arsimor, sistemin gjyqësor, furnizimin me energji elektrike dhe telekomunikacionin, mirëqenien sociale dhe pensionet – kjo renditje nuk do të thotë që përfshin të gjitha, por tregon se “institucionet paralele” mbulojnë të gjithë sektorët e kështu mund të shmangen pothuajse të gjithë kontaktet me institucionet e Kosovës dhe të mund të jetojnë me shërbimet e ofruara nga institucionet e udhëhequra dhe financuara nga Serbia.

Institucionet e Kosovës veprojnë në pjesën veriore të Kosovës, edhe pse prezenca e tyre është e kufizuar. Lëshimi i dokumenteve të Kosovës është një prej shërbimeve të pakta komunale që funksionojnë. Institucionet e Kosovës janë të gjendje të ofrojnë përkujdesje shëndetësore dhe arsimim kryesisht për shqiptarët e Kosovës dhe komunitetet tjera jo-serbe që jetojnë në këtë zonë. Policia e Kosovës është prezentë në të gjitha komunat. GNK e karakterizon situatën si “sovrانيتet të dyfishtë”, duke përmbledhur:

*“Institucionet e Serbisë dhe Kosovës kryqëzohen dhe mbulojnë njëra tjetrën në Veri pa ndonjë kufi ose rregulla zyrtare. Komunitetet e shumicës serbe dhe pakicës shqiptare jetojnë brenda strukturave të ndara shoqërore, politike dhe të sigurisë. Ata kanë zhvilluar mënyra pragmatike për të lëvizur në mes të këtyre sistemeve paralele ku bashkëpunimi është i pashmangshëm.”<sup>23</sup>*

### 2.4. Barrikatat

Pas deklaramit të pavarësisë së Kosovës, Serbia nuk ka lejuar mallrat e Kosovës me dokumente të Kosovës që të futen në Serbi. Pasi që kjo çështje dështoi të diskutohet dhe

---

<sup>19</sup> Për një përmbledhje të detajuar mbi institucionet e financuara nga Serbia dhe ndikimi i Serbisë në Kosovë, shiko GNK 2011

<sup>20</sup> Shiko gjithashtu KIPRED 2008, f. 10

<sup>21</sup> Shiko Banka Botërore 2009, f. 20

<sup>22</sup> Shiko Haener 2011, f. 31f

<sup>23</sup> GNK 2011, f. i



zgjidhet në “dialogun teknik” të ndihmuar nga BE-ja me 20 korrik 2011, qeveria e Kosovës vendosi të zbatoj ndalesën reciproke ndaj mallrave nga Serbia. Me 25 korrik 2011, Njësia Speciale e Operacioneve Zonëale (ROSU) e policisë së Kosovës u dërgua në pikë kalimet kufitare në Pjesën veriore të Kosovës, Jarinë dhe Bërnjak, në mënyrë që të implementohet kjo ndalesë dhe të vendosen Doganat e Kosovës, e cila nuk kishte punëtorë aty prej vitit 2008. Ky veprim shkaktoi përplasje të dhunshme ku u vra një polic i Kosovës. ROSU u tërhoq, serbët e Kosovës ngritën barrikada e KFOR-i morri përsipër situatën dhe vazhdon ta kontrolloj zonën. Rrugët kryesore që qojnë drejt dy pikë kalimeve kufitare janë të bllokuara me barrikada, dhe “rrugët alternative”, shtigjet malore, përdoren si mënyra e vetme për të kaluar dhe të dalë nga pjesët e ndryshme të Kosovës veriore dhe Serbisë. Situata është bërë e brishtë dhe e paqëndrueshme. Mosmarrëveshja ka tejkaluar pikën fillestare të zbarkimit ose jo të zyrtarëve të doganave të Kosovës në pikë kalimet e përmendura kufitare. Beogradi për një kohë, kishte përkrahur serbët e Kosovës në ngritjen dhe mbajtjen e barrikadave si mjet paqësor për “luftën legjitime për të drejtat e tyre”. Sidoqoftë, pas presionit nga Bashkimi Evropian, Beogradi ka vendosur që prej dhjetorit të ndërroj retoriken. Kryetari i Serbisë, i përcjellë nga ministra dhe politikan tjerë të lartë, tash po kërkojnë që serbët e Kosovës të largojnë barrikadat.

Pjesa veriore e Kosovës ballafaqohet me problemin e dy qëllimeve dhe qëndrimeve politike të kundërta të palëve të përfshirë: integrimi në sistemin e Kosovës kundrejt mbetjes në sistem ose ri-integrimi në sistemin e Serbisë. Barrikadat kanë çimentuar ndarjen ekzistuese në kuptim të plotë të fjalës. Pa asnjë dyshim, kjo ka pasur ndikim në humultim. Intervistat e para janë bërë në tetor 2011, kur shumica e njerëzve ende shpresonin se çështja mund të zgjidhet shpejt. Disa partner potencial të intervistave refuzuan të pyetshin pasi që “kjo nuk ishte koha e duhur”, të tjerët ishin më të kujdesshëm në përgjigjet e tyre se sa që do të ishin para barrikadave. Në përgjithësi, një presion dhe depresion i madh mund të vërehet. Bilës më shumë se sa që kufizon fizikisht lëvizjen, barrikadat dukej se kishin një ndikim të madh psikologjik posaçërisht për ata që ishin të hapur ndaj bashkëpunimit ndëretnik. Kjo barrë psikologjike nuk duhet të nënvlerësohet.

### **3. Përmbledhje e marrëdhënieve ndëretnike**

#### **3.1. Linjat gjeografike të ndarjes**

Pjesa veriore e Kosovës perceptohet si e ndarë nga pjesa tjetër e Kosovës, me Mitrovicën si simbol të qytetit të ndarë. Dhe në fakt pothuajse gjithçka dhe çdokush është i ndarë. Sistemet shëndetësore dhe të arsimit veprojnë ndaras; fëmijët e shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës nuk takohen fare që nga çerdhja e deri te universiteti brenda sistemit arsimor. Të gjitha fshatrat shqiptare në pjesën veriore janë të qasshme – së paku përmes rrugëve anësore – pa kaluar nëpër “territorin serb”. Zona e përzier etnikisht Tre Rrokaqiejt në Mitrovicën veriore ka një ekstra urë për këmbësor afër urës kryesore në Mitrovicë, për të pasur mundësinë e kalimit në jug pa kaluar nëpër “lagjet serbe”. Zona e përzier, Kodra e Minatorëve, është e lidhur me Mitrovicën jugore me një ekstra linjë të autobusëve – e cila kalon nëpër Mitrovicën veriore, por nuk ndalet në asnjë stacion të autobusit në veri. E njëjta vlen edhe për fshatrat shqiptare në komunën e Leposaviqit; para se të ngriheshin barrikadat, autobusi nga dhe për në Mitrovicën jugore udhëtonte tri herë në ditë pa u ndalur në vendet e banuara me serb gjatë udhës<sup>24</sup>.

---

<sup>24</sup> Që nga vendosja e barrikadave, rruga që shpie drejt fshatrave shqiptare përmes komunës së Leposaviqit ishte e bllokuar; vetëm një rrugë alternative makadam i lidhë fshatrat me Mitrovicën, duke anashkaluar territorin “serb” dhe barrikadat.

Nuk ka transport publik për të shkuar në Leposaviq që është afër për shembull. Shqiptarët e Kosovës që jetojnë në pjesën veriore të Kosovës kryejnë blerjet kryesisht në jug. Sistemi shëndetësor funksionin i ndarë në atë të financuar nga Serbia dhe ato të udhëhequra nga Kosova dhe i trajtojnë komunitetet e tyre respektive ndaras. Për shumicën e madhe të shqiptarëve të Kosovës që jetojnë në jug, dhe shumicën e madhe të serbëve të Kosovës që jetojnë në veri të Ibrit, nuk ka nevojë dhe mundësi të rastësishme për t'u takuar. E njëjta vlen edhe për shqiptarët dhe serbët e Kosovës që jetojnë në veri: infrastruktura dhe resurset e ofruara nga "institucionet paralele" lejojnë shmangien e kontaktit. Shumica e rrugëve, transportit me autobus, urat, që janë ndërtuar pas luftës janë krijuar pikërisht me këtë qëllim: shmangien e kontakteve ndëretnike dhe me këtë zvogëlimin e potencialit për konflikt të mëtejshëm dhe të rrisë (ndjenjën e) sigurinë për komunitetet respektive. Shmangia e kontaktit si masë e parandalimit të konfliktit konsiderohet si mundësi praktike për të vazhduar jetën në zonën e njëjtë nga disa banorë të fshatrave të shqiptarëve të Kosovës në Leposaviq dhe Zveçan, së paku derisa të rindërtohet një nivel i besimit në mes të dy komuniteteve, shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës<sup>25</sup>.

Kur ishin bllokuar me barrikada shumë rrugë në mes të vendeve të banuara me shqiptarë dhe serb të Kosovës, jo vetëm te lumi Ibër, por edhe në vet pjesën veriore të Kosovës, ishte esenciale për shqiptarët e Kosovës që jetonin atje të kenë "qasje speciale". Sidoqoftë, duke jetuar ndaras, duke iu qasur institucioneve të ndara, duke përdorur infrastrukturë të ndarë deri në një masë, mund ta bëjë sfiduese tejkalimin e ndarjes etnike në afat të gjatë.

Janë vetëm disa vende ku njerëzit nga komunitetet e ndryshme takohen në jetën e përditshme. Këto janë kryesisht lagje të përziera etnikisht, siç janë Kodra e Minatorëve, Suhodolli, dhe posaçërisht Lagja e Boshnjakëve, ku tregtia e ka kthyer këtë lagje në një treg shumënyk gjatë viteve të fundit. Shitoret mbahen kryesisht nga shqiptarët e Kosovës, ndërsa klientët janë kryesisht serb të Kosovës, nga cilado pjesë e Ibrit e jo patjetër banorë të Lagjes së Boshnjakëve. Këto lagje të përziera zakonisht janë të qasshme për të gjitha komunitetet pa asnjë frikë.

### **3.2. Motivimi për kontakt përtej linjave**

Përkundër të gjitha sfidave dhe pengesave, kontakti ndëretnik është rritur gjatë viteve të fundit, edhe pse opinionet në mes të partnerëve të intervistave dallojnë për atë se cilin nivel e kanë arritur këto marrëdhënie dhe sa kanë ndikuar vendosja e fundit e barrikadave në to. Janë disa motive për të bërë përpjekje në angazhim për komunikim dhe kontakt ndëretnik, qoftë për qëllime të biznesit apo punës aktive kundër ndarjes. Partnerët e intervistave kanë përmendur prosperitetin ekonomik si dhe mundësinë e anëtarësimit në BE, në të cilën edhe Serbia edhe Kosova synojnë të hyjnë, të jenë disa nga forcat kryesore udhëheqëse. Shikimi për t'u bërë anëtar i një unioni më të madh me një diversitet të gjerë kulturor, dhe në të njëjtën kohë të mos komunikosh me fqinjët që jetojnë në të njëjtin qytet ose në fshatin tjetër është paradoksale. Sidoqoftë është vërejtur nga ata që janë intervistuar se ky qëndrim paradoksal nuk do të tolerohej nga BE-ja e cila thekson nevojën për

---

<sup>25</sup> Intervistat me zyrtarët shqiptarë komunal të Kosovës, 24 tetor 2011, dhe me banorët shqiptarë të Kosovës në komunat veriore, 28 nëntor 2011; fshati i shqiptarëve të Kosovës në komunën e Zubin Potokut, Çabër, është shumë më afër Mitrovicës se sa me Zubin Potokun; orientimi drejt Mitrovicës (jug) dhe jo drejt Zubin Potokut është më pak strategji e shmangies së kontaktit por gjithashtu edhe çështje e zgjidhjes më praktike.

marrëdhënie të mira fqinjësore<sup>26</sup>. Të tjerët e bazojnë angazhimin e tyre në marrëdhënie ndëretnike mbi argumentin se njeriut i nevojiten dhe varet nga fqinjët të cilët jetojnë nën të njëjtin qiell dhe thithin të njëjtin ajër. Diversiteti kulturor shihet si pasurim, “sa më mirë që i njej komunitetet tjera, aq më i vlefshëm je si person; sa më shumë kultura të njej, aq më i pasur je<sup>27</sup>”.

Në përgjithësi, shumica e kontakteve ndëretnike ndodhën në marrëdhëniet private individuale si dhe në biznes dhe tregti. Jo vetëm që ka bashkëpunim në mes të kompanive, por ka edhe raste kur shqiptarët dhe romët e Kosovës punojnë në pjesën veriore kryesisht në ndërtimtari ose si punëtor ditor. Kontaktet ndëretnike gjithashtu krijohen në vende të punës siç janë OJQ-të e ndryshme, organizatat ndërkombëtare, dhe agjencitë, si dhe përmes aktiviteteve të organizuara nga OJQ-të.

Komunikimi ndëretnik mund të vështrohet edhe në nivelin institucional. Një prej shërbimeve të pakta që komunat e Kosovës ofrojnë në veri janë lëshimi i dokumenteve të Kosovës, siç janë letërnjoftimet dhe pasaportat. Këta zyrtar komunal operojnë në fshatra shqiptare. Një numër konsiderueshëm i madh i serbëve të Kosovës udhëtojnë në këto fshatra për të aplikuar për letërnjoftim të Kosovës, dhe kjo krijon një rast të mirë për atë se ku dhe si bëhen kontaktet ndëretnike. Letërnjoftimet e Kosovës janë të nevojshme së fundi për të marrë pensionin e paguar nga institucionet e Kosovës. Serbët e Kosovës që aplikojnë për këto dokumente nuk janë të gatshëm të humbin përfitimet vetëm për hir të përcjelljes së motos publike të serbëve të Kosovës dhe politikanëve serb për mospranimin e institucioneve të Kosovës. Në mënyrë individuale dhe të qetë, ata përcjellin një politikë tjetër nëse është në interes të tyre personal. Mirëpo, barrikatat e ngritura së fundi kanë krijuar rënie – por jo ndalje të plotë – në aplikimin e serbëve të Kosovës për shkak të vështirësive me të cilat ballafaqohen për të anashkaluar këto barrikada.

### 3.3. Biznesi

Aktivitetet e biznesit duket se janë më pak problematike për angazhimin ndëretnik. Shumë prej parterëve të intervistave kanë theksuar se ata besojnë që marrëdhëniet biznesore janë duke funksionuar mjaftë mirë, kryesisht duke iu referuar tregtisë në Lagjen e Boshnjakëve si një treg i madh shumëtnik. Nuk ka shifra se sa kompani bashkëpunojnë “përtej linjave etnike”, pasi që shumë prej tyre angazhohen në aktivitete biznesore të profilit të ulët, dhe vlerësimet në mesin e biznesmenëve dallojnë<sup>28</sup>. Është e njohur gjerësisht se tregtia dhe bashkëpunimi biznesor kryesisht ka një ndikim pozitiv në marrëdhëniet ndëretnike dhe se bashkëpunimi është përmirësuar dukshëm gjatë viteve të fundit. “Biznesi nuk njej nacionalitet” dhe “tregtia lidhë njerëzit” janë disa prej thënieve që thuhën shpesh. Bashkëpunimi në sektorin biznesor funksionon mirë, sepse siç edhe kanë thënë disa prej tyre, biznesi sjell përfitim për të gjithë ata që janë përfshirë: biznesmenët janë të interesuar në fitim, jo në prejardhje etnike, njerëzit donë të gjejnë vende pune dhe punëtorët të

---

<sup>26</sup> Intervista me përfaqësuesit e OJQ-ve të shqiptarëve të Kosovës, 02 nëntor 2011, biznesmen shqiptar të Kosovës, Mitrovicë, 31 tetor 2011

<sup>27</sup> Intervista me përfaqësuesit e OJQ-ve të shqiptarëve të Kosovës, Mitrovicë, 02 nëntor 2011

<sup>28</sup> Ku një biznesmen shqiptar i Kosovës në Mitrovicë vlerëson se gjysma e kompanive në Pjesën veriore të Kosovës janë të regjistruara në Kosovë, me dokumente të institucioneve të Kosovës, një konsulent biznesor, shqiptar i Kosovës, beson se ky numër është “relativisht i ulët”; të jesh i regjistruar në institucione të Kosovës nënkupton të kesh marrëdhënie biznesore me kompani në pjesë tjera të Kosovës të cilat janë kryesisht në pronësi të shqiptarëve të Kosovës, ose së paku tentojnë që të krijojnë marrëdhënie të tilla biznesore. Intervista me biznesmen shqiptar të Kosovës, Mitrovicë, 31 tetor 2011, dhe konsulentin biznesor, shqiptar i Kosovës nga Mitrovica, 03 nëntor 2011

fitojnë, “vetëm paraja i pajton njerëzit, jo flamuri” përfundoi një biznesmen serb i Kosovës.<sup>29</sup>

Barrikadat kanë pasur ndikim të madh në aktivitetet biznesore. Për shembull, tregtia në Lagjen e Boshnjakëve ka rënë në përafërsisht 50 përqind, që nga ngritja e barrikadave.<sup>30</sup> Një konsulent biznesor i intervistuar pret që shumë dyqane do të mbyllen së shpejti pasi që nuk mund të paguajnë qiranë<sup>31</sup>. Dy prej tre biznesmenëve serb të Kosovës të intervistuar nuk janë në gjendje ti shesin produktet e tyre – tregu i tyre është Kosova jugore, por për shkak të barrikadave dhe tensioneve të larta ata nuk janë në gjendje të transportojnë mallrat e tyre në jug të lumit Ibër. Humbjet ekonomike janë të konsiderueshme; njërit prej tyre tashmë i është dashur të largoj disa punëtor<sup>32</sup>. Në kohën e intervistës në tetor, është raportuar se disa punëtor shqiptar të Kosovës ende punojnë në ndërtimtari në pjesën veriore të Kosovës por numrat e tyre kanë rënë në mënyrë të konsiderueshme në krahasim me kohën para ngritjes së barrikadave.

### 3.4. Organizatat e shoqërisë civile

Në dy vitet e fundit, janë organizuar një mori e aktiviteteve të ndryshme ndëretnike në Mitrovicë dhe pjesën veriore të Kosovës. Një kompilim i projekteve të implementuara në vitet 2010/11<sup>33</sup> tregon se më shumë se pesëdhjetë aktivitete janë implementuar nga pothuajse po aq organizata të ndryshme ku janë përfshi më shumë së njëmijë pjesëmarrës. Llojet e aktiviteteve janë të ndryshme – nga trajnimet, seminarët dhe punëtoritë, deri te ndërtimi i rrjeteve, nga fëmijët dhe grupet rinore, pastrimit të përbashkët të lumit Ibër, ofrimit të kurseve të gjuhës shqipe për serbët e Kosovës, mbajtjes së shkollave për rok; publikimit të një magazine të re në të gjitha gjuhët; organizimit të turnirëve sportive dhe ekskursioneve të përbashkëta deri te ofrimi i projekteve për grupe të grave dhe zhvillim ekonomik.

Shumica e këtyre aktiviteteve janë implementuar nga më pak se dhjetë organizata, prej të cilave pesë janë shumë aktive. Shumica e organizatave kanë kryer së paku një ngjarje me komponentë ndëretnike, shpesh në bashkëpunim me OJQ-të tjera. Disa OJQ që janë shumë aktive kryesisht janë duke implementuar projekte afatgjate. Shumica e OJQ-ve janë themeluar si organizata “mono-etnike”, të cilat implementojnë aktivitete të caktuara me OJQ tjera “mono-etnike”. Intensiteti i këtyre kontakteve shkon nga i dobët, që ka të bëjë me implementimin e projekteve afatshkurtra, deri te shumë i konsoliduar, ku bashkërisht udhëhiqet qendra dhe aktivitetet për disa vite. Vetëm disa OJQ ose iniciativa<sup>34</sup> punësojnë personel nga komunitete të ndryshme, dy prej tyre gjenden në Lagjen e Boshnjakëve. Iniciativat dhe organizatat tjera me punëtor të komuniteteve të ndryshme i kanë dy zyre, një në pjesën jugore dhe një në pjesën veriore të Mitrovicës, me bashkëpunim të ngushtë dhe takime të rregullta të personelit. Dy prej organizatave aktive e definojnë vetën si multi-etnike; njëra ka zyrën qendrore në Mitrovicën jugore me personel që vjen nga të dy anët e qytetit.

---

<sup>29</sup> Intervista me biznesmen serb të Kosovës në veri, 01 nëntor 2011

<sup>30</sup> Intervista me përfaqësuesin e komunitetit të boshnjakëve, 13 dhjetor 2011, Mitrovicë

<sup>31</sup> Intervista me konsulentin biznesor, shqiptar të Kosovës nga Mitrovica, 03 nëntor 2011

<sup>32</sup> Intervistë me biznesmen serb të Kosovës në veri, 01 nëntor 2011

<sup>33</sup> Bazuar kryesisht në dokumentet publikisht të qasshme, KIPRED-i ka krijuar një bazë të të dhënave për aktivitetet e implementuara në dy vitet e fundit. Edhe pse baza e të dhënave me siguri nuk është shteruese, jep një përmblendje të llojllojshmërisë të aktiviteteve dhe qasjeve, si dhe llojllojshmërisë së organizatave dhe grupeve të shënjuara. Periudha dyvjeçare është zgjedhur për të pasur një përshtypje të statusit aktual dhe filtrimit të ndikimit të barrikadave.

<sup>34</sup> “Iniciativa” është përdorur për të përshkruar organizatat/grupet e paregjistruara dhe operojnë me nivel të lartë të pavarësisë nga OJQ-të që kanë themeluar iniciativën.

Shumica e madhe e organizatave tanimë veprojnë për disa vite. Disa prej organizatave janë themeluar nga OJQ-të ndërkombëtare dhe më vonë janë transformuar në OJQ lokale. Kundrejt këtij sfondi, është e mrekullueshme që organizata më e re që është themeluar në vitin 2010 e ka bërë këtë pa asnjë ndihmë ndërkombëtare dhe është krijuar nga intelektualët nga pjesa veriore dhe jugore e Mitrovicës si një organizatë multietnike me qëllim të tejkalimit të ndarjes etnike në mes të qytetarëve<sup>35</sup>. Kjo është një qasje relativisht e shquar pasi që dallon nga OJQ-të “mesatare” në atë zonë dhe tregon se – së paku disa – qytetarët e Mitrovicës ndjejnë se duhet të ndryshojnë diçka vet në mënyrë që të rikthejnë marrëdhëniet e thyera.

Pothuajse njëzet përqind e të gjitha aktiviteteve kanë qenë të ndërlidhura me rininë. Njëzet përqind tjera kanë pasur gratë si grup specifik të shënjuar. Disa partnerë të intervistave kanë theksuar se më lehtë është të punohet me gra në fushën e bashkëpunimit ndëretnik, pasi që gratë konsideroheshin se janë më guximtare, më të ndjeshme dhe adresimi i grave faktikisht nënkupton adresimin e të gjithë komunitetit, pasi që gratë ishin më gjithëpërfshirëse<sup>36</sup>. Janë disa organizata të grave të angazhuara në bashkëpunimin ndëretnik; prej pesë organizatave më aktive në bashkëpunimin ndëretnik dy janë organizata të grave, organizatat tjera aktive janë të udhëhequra nga gratë. Fakti se 13 prej 19 përfaqësuesve dhe pjesëmarrësve të OJQ-ve të intervistuar ishin gra tregon rolin e fuqishëm që gratë e luajnë në këtë sektor.

### 3.5. Marrëdhëniet në mes të komuniteteve të ndryshme

Kur të përmenden “marrëdhëniet ndëretike”, zakonisht fokusi është i menjëhershëm dhe shpesh vetëm mbi komunitetet e shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës<sup>37</sup>. Kjo është e kuptueshme duke marrë parasysh madhësinë e këtyre dy komuniteteve, si dhe vështrimet armiqësore politike të ndërlidhura me to. Sidoqoftë, është gabim të fokusohet vetëm në shqiptarët dhe serbët e Kosovës dhe të harrohen dhe marginalizohen komunitetet tjera, paralajmëron një përfaqësues shqiptar i Kosovës i një organizate multietnike<sup>38</sup>. Një përfaqësues i OJQ-së nga Mitrovica veriore është ankuar se shumë donatorë konsideronin se projektet janë ndëretnike vetëm nëse përfshijnë edhe shqiptarët edhe serbët e Kosovës, por jo nëse adresonin vetëm njërin prej këtyre dyjave dhe komunitetet tjera.<sup>39</sup>

Përfaqësuesja romë e një OJQ-je theksoi se komuniteti i saj thjeshtë dëshiron të jetojë në paqe dhe të ketë marrëdhënie të mira me të gjithë. Ata bashkëpunojnë dhe punojnë me “këndo që i thërret”, por gjithashtu përmendi se ndjen se romët janë si “top i futbollit”, të lëvizur nga njëra anë në tjetrën, respektivisht duke qenë në mes të të gjitha palëve<sup>40</sup>. Një udhëheqës i OJQ-së, shqiptarë i Kosovës, i cili bashkëpunon me njërin prej OJQ-ve të romëve thotë se nevojitet mbështetje e mëtejme për komunitetin rom që jeton në Mitrovicën jugore, në Mëhallën e Romëve, “sepse janë në jug për vetëm dy ose tri vite, pasi që kthimi kishte filluar vetëm atëherë dhe ende ka nevojë të punohet në ri-integrim<sup>41</sup>”. Për shumë shërbime, siç janë trajtimet mjekësore, shkollat etj, romët (ende) janë më të orientuar nga Mitrovica veriore pasi që merrnin përkrahje nga institucionet e udhëhequra

<sup>35</sup> Intervista me përfaqësuesit shqiptarë të Kosovës të OJQ-së në Mitrovicë me 11 nëntor 2011

<sup>36</sup> Intervista me përfaqësuesit shqiptarë të Kosovës të OJQ-së në Mitrovicë, 02 nëntor 2011, pjesëmarrësit e aktiviteteve të OJQ-ve/banorë të lagjeve të përziera, 10 nëntor; përfaqësues shqiptarë të Kosovës të OJQ-së në Mitrovicë, 02 nëntor 2011, dhe përfaqësues shqiptarë të Kosovës të OJQ-së, 31 tetor 2011

<sup>37</sup> Për një përmbledhje të detajuar dhe gjithëpërfshirëse mbi komunitetet e Kosovës shiko Profilët e Komuniteteve OSBE 2011

<sup>38</sup> Intervistë me përfaqësuesin shqiptar të Kosovës të OJQ-së, Mitrovicë, 11 nëntor 2011

<sup>39</sup> Intervistë me përfaqësuesin e OJQ-së në Mitrovicën veriore me 26 tetor 2011

<sup>40</sup> Intervistë me përfaqësuesin romë të OJQ-së, Mitrovicë, 24 tetor 2011

<sup>41</sup> Intervistë me përfaqësuesin shqiptar të Kosovës të OJQ-së në Mitrovicë, 02 nëntor 2011

nga serbët kur jetonin në kampet në pjesën veriore të Kosovës pasi që ishin zhvendosur nga Mëhalla e Romëve në jug.

Komunitetet e turqve dhe boshnjakëve në përgjithësi perceptohen si të integruar ose “nuk kanë ndonjë vështirësi specifike<sup>42</sup>” në relacion me cilindo komunitet tjetër. Disa partner të intervistave kanë treguar se boshnjakët janë në pozitë të posaçme për të ndërmjetësuar në mes të shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës, ose të krijojnë lidhje në mes tyre, në kohërat kur është vështirë të vendoset kontakti i drejtpërdrejt. Shembujt e dhënë nga partnerët e intervistave që të gjithë ishin të lidhur me rastet e boshnjakëve që ofronin transport për mallrave dhe persona si vozitës të maunave dhe taksive. Prapë, që prej ngritjes së barrikadave, duke iu falënderuar taksi vozitëse boshnjak, serbët e Kosovës mund të shkojnë në fshatrat shqiptare për të aplikuar për dokumente<sup>43</sup>. Boshnjakët që jetojnë në veri të Ibrit, si dhe ata që jetojnë në Lagjen e Boshnjakëve, janë më të orientuar nga jugu dhe të integruar në sistemet dhe shoqërinë e Kosovës, përderisa boshnjakët që jetojnë në komunën e Leposaviqit janë të integruar në shoqërinë dhe institucionet që funksionojnë atje; faktikisht ata shkojnë në shkolla të financuara nga Serbia dhe punojnë në institucionet shëndetësore dhe arsimore të udhëhequra nga institucionet serbe. Boshnjakët që jetojnë në Mitrovicën veriore lëvizin në jug dhe veri, punojnë në të dy institucionet. Si komunitet, shpesh e kanë ndier vetën së “në mes dy zjarreve”, por gjithmonë mundohen të gjejnë një bilanc në mes të komuniteteve të shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës<sup>44</sup>, shpjegon një përfaqësues i komunitetit. Sipas mendimit të tij, mundësia për krijimin e lidhjeve në mes të shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës qëndron në faktin se boshnjakët ndajnë gjuhën me serbët e Kosovës – edhe pse pak e ndryshme<sup>45</sup> – dhe fenë e njëjtë me shqiptarët e Kosovës si dhe përkrahjen për pavarësinë e Kosovës që nga viti 1990. Shumë boshnjakë flasin rrjedhshëm gjuhën shqipe.

Funksioni i lidhjes të komuniteteve të shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës është karakteristikë e Lagjes së e Boshnjakëve në Mitrovicë, jo vetëm për shkak të popullsisë së përzier që jeton aty me një numër relativisht të madh të boshnjakëve, por gjithashtu për shkak të lokacionit atraktiv në mes të zonave të banuara kryesisht nga serbët e Kosovës në njërin anë dhe shqiptarëve të Kosovës në anën tjetër.

## 4. Sfidat dhe qasjet

### 4.1. Politikat

#### *Rëndësia e politikave*

Duke shikuar zhvillimet e fundit, barrikadat dhe ndarjen e dukshme në mes të komuniteteve të shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës në pjesën veriore të Kosovës, mund të duket se aktivitetet dhe tregtia ndëretnike nuk kanë kurrfarë ndikimi dhe nuk janë në gjendje të afrojnë ndarjen. Siç është elaboruar më herët, pajtimi është proces shumëdimensional, i cili kërkon angazhim në nivelin bazë si dhe në nivelin politik. Përderisa aktivitetet e OJQ-ve dhe bizneseve luajnë një rol të rëndësishëm në krijimin e kontakteve në mes të komuniteteve dhe njerëzve, mosmarrëveshja politike në mes të

---

<sup>42</sup> Intervistë me përfaqësuesin shqiptar të Kosovës të OJQ-së në Mitrovicë, 02 nëntor 2011

<sup>43</sup> Intervista me përfaqësuesin shqiptar të Kosovës të komunës në Pjesën veriore të Kosovës me 18 tetor 2011, dhe përfaqësuesin shqiptar të Kosovës të OJQ-së me 26 tetor 2011, dhe me konsulentin biznesor shqiptar të Kosovës me 03 nëntor 2011

<sup>44</sup> Intervistë me përfaqësuesin e komunitetit boshnjak në Mitrovicë, 13 dhjetor 2011

<sup>45</sup> Zyrtarisht gjuha serbe dhe gjuha boshnjake janë dy gjuhë, por ato janë shumë të ngjashme. Çdo kush që e din njërin prej tyre gjithashtu kupton gjuhën tjetër.

\* Intervistë me përfaqësuesin serb të Kosovës të OJQ-së, Mitrovicë, 26 tetor 2011

Kosovës dhe Serbisë, së bashku me rregullimin e turbullt institucional në veri, shkon plotësisht kundër përpjekjeve të tilla. Në këtë situatë, aktivitetet bazë me siguri vështirë se do të arrinin më shumë se sa të përgatisin terrenin për krijimin dhe mbajtjen e marrëdhënieve ndëretnike. “Tash nuk është koha që të fillohet bashkëpunimi, mund thjeshtë të presim dhe të krijojmë kontakte në ndërkohë”, është strategjia e ndjekur nga organizata posa e themeluar multietnike lokale<sup>46</sup>. Ky vlerësim ndahet nga disa OJQ tjera të cilat nuk po fillojnë projekte të reja për momentin. Ato që tanimë kanë kontakte dhe bashkëpunim ndëretnik për disa vite, vazhdojnë me aktivitetet e tyre pasi që marrëdhënia dhe besimi i krijuar me kohë është treguar mjaft i fortë për të vazhduar, siç vëren një përfaqësues i OJQ-së në Mitrovicë: “ne punojmë, vazhdojnë nuk jemi ndalur as për një ditë. Mendoj se njerëzit e kanë kuptuar se kjo nuk është diçka në mes të komuniteteve, kjo është diçka më e fortë; ka të bëjë me politikë.”<sup>47</sup> Ka besim se “kontaktet që janë arritur brenda disa viteve nuk mund të humben brenda disa muajve”<sup>48</sup>.

*“[...] derisa mundohet të përgjigjet nëse Kosova është republikë, nëse është Serbi, ose e pavarur, nuk mund të jetohet. Nesër mund të bërtas “Kosova është Serbi”, por nuk kam ujë, energji elektrike, nuk mund të gjejë punë – ose mund të bërtas “Kosova është republikë”, por në anën tjetër, jeta është katastrofë. Ne fokusohemi në zgjedhjen e problemeve tona reale”*<sup>\*</sup>

#### *Politika “jo-politike”*

Bashkëpunimi ndëretnike në nivelin bazë në përgjithësi funksionon mirë vetëm nëse lihet anash politika. Ky është vlerësimi i pothuajse të gjithë personave të intervistuar edhe në sektorin e biznesit edhe atë të shoqërisë civile. Si një mantra, është përsëritur shumë herë nga të gjithë: “Nuk merremi me politikë”. “Kjo është mënyra e vetme për të mbajtur bilancin dhe marrëdhëniet<sup>49</sup>”. Mos diskutimi i opinioneve të ndryshme politike shërben si strategji e parandalimit të konfliktit.

*“Për dikë Kosova është shtet, për dikë tjetër Kosova nuk është shtet. Por kjo nuk na pengon neve që të kryejmë punën tonë. Të përfundojmë atë që ia kemi borxh komunitetit tonë, fëmijëve tonë, të pensionuarve tonë ose kujt do qoftë. Në zakonisht nuk flasim për gjëra të tilla. A është kjo gjë e mirë a jo është pikëpyetje. Por është mënyra e vetme se si funksionon. [...] Nëse ju thoni që kjo është e zezë, dhe unë them se kjo është e bardhë, atëherë mundohemi ta bindim njëri-tjetrin që kjo është e zezë ose e bardhë dhe nuk do të përfundim asnjëherë.”*<sup>50</sup>

Përveç që mos diskutimit të çështjeve politike, implementimi i mëtejshëm i politikës “jo-politike” duket pak më ndryshe në organizata të ndryshme. Veprimi me neutralitet ndaj statusit është posaçërisht e rëndësishme për organizatat që veprojnë në pjesën veriore të

*“Gjithmonë gjendemi në ndonjë “situatë”, gjithmonë. Asnjëherë nuk kemi qenë pa një “situatë”. Le ta zgjedhim më në fund.”*<sup>\*</sup>

Kosovës; shmangia e çfarëdo dyshimi se mund të njohin institucionet dhe shtetësinë e Kosovës përmes projekteve të tyre është kusht i domosdoshëm për të vepruar atje<sup>51</sup>.

\* Intervistë me përfaqësuesin serb të Kosovës të OJQ-së, Mitrovicë, 26 tetor 2011

<sup>46</sup> Intervistë me përfaqësuesin shqiptar të Kosovës të OJQ-së, Mitrovicë, 11 nëntor 2011

<sup>47</sup> Intervistë me përfaqësuesin shqiptar të Kosovës të OJQ-së, Mitrovicë, 02 nëntor 2011

<sup>48</sup> Intervistë me përfaqësuesin shqiptar të Kosovës të OJQ-së, Mitrovicë, 26 tetor 2011

<sup>49</sup> Intervistë me përfaqësuesin shqiptar të Kosovës të OJQ-së, Mitrovicë, 31 tetor 2011

<sup>50</sup> Intervistë me përfaqësuesin e OJQ-së në Mitrovicën veriore me 26 tetor 2011

<sup>51</sup> Intervista me tre përfaqësues të tri OJQ-ve të ndryshme në Mitrovicën e veriut me 20 tetor 2011, 24 tetor 2011, 26 tetor 2011

Shumica e OJQ-ve kanë zhvilluar një qasje pragmatike<sup>52</sup> kur merren me dy sistemet institucionale, institucionet “paralele” dhe institucionet e Kosovës. Mbajnë kontakt me përfaqësuesit e të dy sistemeve institucionale nëse është e nevojshme, ndonjëherë edhe duke i sjellë zyrtarët e të dy anëve në të njëjtën tavolinë për të diskutuar ose për tu pajtuar mbi një çështje. Kjo qasje nuk përfshin pranimin e legjitimitetit të të dy sistemeve; është një qasje e pastër pragmatike duke u mundur që të zgjidhen problemet me ata që janë në pozitë t’i zgjedhin ato<sup>53</sup>.

Një qasje e ngjashme pragmatike ndaj këtyre institucioneve mund të vërehet në lidhje me aplikimin e serbëve të Kosovës për dokumente të Kosovës dhe regjistrim të automjeteve. Gjithashtu ka raste kur, përveç që i regjistrojnë kompanitë e tyre sipas legjislacionit serb, serbët e Kosovës i regjistrojnë kompanitë e tyre sipas legjislacionit të Kosovës për t’i përmbushur nevojat e tyre biznesore<sup>54</sup>. Siç shprehet një ndërmarrës serb i Kosovës “dua të bëjë biznes këtu në Kosovë, kështu që regjistrohem këtu gjithashtu dhe i paguaj të gjitha tatimet. Dua të jetojë këtu dhe dua që edhe fëmijët e mi të jetojnë këtu”<sup>55</sup>. Ngjashëm, është raportuar se edhe shqiptarët e Kosovës kanë regjistruar kompanitë e tyre sipas legjislacionit serb.<sup>56</sup>

### *Kërkesat zgjidhje politike*

Edhe pse askush nuk është angazhuar në bisedimet për bashkëpunim ndëretnik për politikë, të gjithë partnerët e intervistave kërkojnë një zgjidhje për “situatën” – që nënkupto edhe zgjidhjen e menjëhershme (largimin e barrikadave, largimi i kufizimeve fizike, ulja e tensioneve të larta) dhe zgjidhje afatgjate (një kornizë politike e cila sqaron se kush dhe cili institucion, cili sistem çka ka në kontroll dhe më këtë do t’i jepej fund konfliktit politik). Vështirësitë aktuale në bashkëpunim vlerësohen se janë më pak ndëretnike e më shumë të natyrës politike<sup>57</sup>. Shumë biznesmen, zyrtar komunal, përfaqësues të OJQ-ve nga të dy anët e Ibrit, ndihen të lodhur nga konflikti i pazgjidhur i cili iu konsumon shumë energji<sup>58</sup>. Posaçërisht barrikadat dhe tensionet janë përjetuar si një “barrë psikologjike”<sup>59</sup>.

*“Duhet të gjendet një kompromis ku të dy palët do të jenë të pakënaqura. Le të jetë ashtu.”\**

<sup>52</sup> Disa janë shumë strikt e nuk bashkëpunojnë me asnjë institucion të cilitdo sistem për të mbajtur neutralitetin e plotë; intervistë me përfaqësuesin serb të Kosovës të OJQ-së, Mitrovicë, 24 tetor 2011

\* Intervistë me përfaqësuesin të OJQ-së në Mitrovicë veriore, 26 tetor 2011

<sup>53</sup> Shembuj të bashkëpunimit të tillë janë përmendur në tri intervista me përfaqësuesit e OJQ-ve në Mitrovicë veriore, 19 tetor 2011 dhe 26 tetor 2011; të jesh status-neutral është gjithashtu e rëndësishme për donatorët nëse punojnë në Pjesën veriore të Kosovës, intervistë me përfaqësuesin ndërkombëtar të agjencisë ndërkombëtare, Prishtinë, 20 tetor 2011

\* Intervistë me përfaqësuesin serb të Kosovës të OJQ-së, Mitrovicë, 24 tetor 2011

<sup>54</sup> Një biznesmen serb i Kosovës i intervistuar kishte kompaninë e tij të regjistruar në Kosovë vetëm sipas ligjeve të Kosovës pasi që tregu i tij ishte vetëm brenda Kosovës, në jug të Ibrit, duke bashkëpunuar me kompanitë e shqiptarëve të Kosovës. Që nga korriku i vitit 2011 ai nuk është në gjendje t’i dërgoj mallrat e veta më dhe i është dashur ta ndalë biznesin. Intervista me 01 nëntor 2011.

<sup>55</sup> Intervista me 01 nëntor 2011

<sup>56</sup> Intervistë me biznesmen serb të Kosovës me 01 nëntor 2011

<sup>57</sup> Intervistë me zyrtarë shqiptarë të Kosovës nga komuna e Kosovës në veri, 24 tetor 2011, dhe me përfaqësues shqiptar të Kosovës të OJQ-së në Mitrovicë, 02 nëntor 2011

<sup>58</sup> Intervistë me zyrtarë komunal shqiptarë të Kosovës nga komuna e Kosovës në veri, 24 tetor 2011, me përfaqësues shqiptar të Kosovës të OJQ-së, Mitrovicë, 26 tetor 2011, me përfaqësues të OJQ-së në Mitrovicë veriore, 26 tetor 2011, me përfaqësues shqiptar të Kosovës të OJQ-së, 02 nëntor 2011.

<sup>59</sup> Intervistë me zyrtar komunal nga komuna e Kosovës, Mitrovicë, 19 tetor 2011



*“Është kjo barrë e pritjes përditë se çka do të ndodhë; a do t’i largojnë barrikatad apo nuk do ti largojnë barrikatad? A do të gjuaj dikush prapë a jo? – Jemi mësuar të jetojmë me këto gjëra, por në ndërdijën tonë ka shumë tension dhe presion të madh.”<sup>60</sup>*

Politika ka një ndikim të madh në operacionet e OJQ-ve dhe sektorit të biznesit. Të dy sektorët ndjejnë se nuk kanë ndikim në situatën politike, as në lidhje me situatën imediate dhe barrikatad e as në gjetjen e një zgjedhje afatgjate. Duke iu referuar presion të madh brenda komunitetit, një biznesmen serb i Kosovës thotë se “Unë jam një serb dhe duhet të veproj si tjerët, nuk mund të shkoj kundër barrikatadave, jam shumë i vogël, nuk kam ndikim – dhe do të ishte shumë e rrezikshme”<sup>61</sup>. Zgjedhja e situatës politike i është lënë politikanëve lokal dhe komunitetit ndërkombëtar, më saktësisht Bashkimit Evropian – por asnjëherë nuk janë përfshi shoqëria civile apo sektori i biznesit të cilët nuk donë të merren me politikë dhe ndjejnë se janë shumë të dobët për të qenë në gjendje të ushtrorinë çfarëdo ndikimi. Sipas një ndërmarrësi shqiptar në Mitrovicë, “sektori i biznesit vështirë se mund të përmirësoj politikën”<sup>62</sup>, përderisa përfaqësues të ndryshëm të OJQ-ve besojnë se shoqëria civile nuk ka ndikim fare dhe se urdhrat politik në pjesën veriore të Kosovës rrjedhin nga Beogradi, kjo krijon një realitet në Mitrovicë të cilin nuk e pëlqejnë.<sup>63</sup>

Gjatë muajve të fundit, shumë propozime janë ngritur nga qeveritë e Kosovës dhe Serbisë dhe akterëve relevant ndërkombëtar. Këto sugjerime shkojnë nga integrimi i Kosovës veriore në institucionet e Kosovës, implementimit të planit të Ahtisaarit, krijimit të qarqeve speciale me një lloj të planit Ahtisaari Plus, deri te ndërrimi i territoreve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Shumica e të intervistuarve përcjellin politikën “jo-politike” dhe nuk kanë shprehur refuzim ose favorizim për asnjërin propozim të bërë deri më tani. Përshtypja më e përhapur është se zgjedhja është brenda një morie të opsioneve të pranueshme<sup>64</sup>, në është e rëndësishme se si duket zgjedhja në detaje; më e rëndësishme është që më në fund të ketë një zgjedhje dhe një kornizë të qartë e stabile brenda të cilës mund të operohet e bashkëpunohet.

*“A quhet shteti Kosovë, Banane, Serbi, Taxhikistan – nuk më intereson. Dua të jetoj normal, një jetë më të mirë.”\**

Shumë partner të intervistave janë optimist se, me një zgjedhje politike, presioni brenda komunitetit dhe tensionet politike do të ulen, dhe se me një kornizë të qartë, njerëzit do të jenë shumë më të gatshëm dhe në gjendje që të takohen dhe bashkëpunojnë. Apo, siç e tha një përfaqësues i OJQ-së shqiptar i Kosovës, marrëdhëniet ndëretnike “nuk do të përmirësohen nëse nuk ndërrojnë pozicionet politike: natyrisht në të dy anët.”<sup>65</sup>

## 4.2. Presioni brenda komunitetit

### *Rregullat e lojës ndëretnike*

I lidhur ngushtë me situatën e përgjithshme politike është presioni brenda komunitetit, që definojnë sjelljen e cila konsiderohet e pranueshme për anëtarët e një komuniteti. Edhe pse këto janë rregulla të pashkruara, ato përbëjnë njëfarë dije të përgjithshme e asaj që merret si

<sup>60</sup> Intervistë me përfaqësues të OJQ-së në Mitrovicë veriore, 26 tetor 2011

<sup>61</sup> Intervistë me biznesmen serb të Kosovës në Pjesën veriore të Kosovës, 01 nëntor 2011

<sup>62</sup> Intervistë me biznesmen shqiptar të Kosovës, Mitrovicë, 31 tetor 2011

<sup>63</sup> Intervistë me përfaqësues shqiptar të Kosovës të OJQ-së, Mitrovicë/Mitrovica, 31 tetor 2011

\* Intervistë me përfaqësues serb të Kosovës të OJQ-së në Mitrovicë, 26 tetor 2011

<sup>64</sup> Ato që shihen si opsione të pranueshme dallojnë në shumë raste, dhe mund të jenë diametralisht të kundërta, në veri dhe jug të Ibrit, por kjo nuk është hulumtuar në detaje në këtë punim.

<sup>65</sup> Intervistë me përfaqësues shqiptar të Kosovës të OJQ-së, Mitrovicë, 02 nëntor 2011

e pranueshme, çka tolerohet në shoqëri dhe pranohet nga anëtarët e një komuniteti specifik. CDA në një hulumtim ka përdorur termin “rregullat e lojës ndëretnike”:

*“Rasti tregon se edhe në komunitetet e shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës, ka “rregulla të lojës” të qarta e të pashkruara në lidhje me atë se kur, si, pse dhe deri në cilën masë njerëzit mund/ duhet të bashkëveprojnë përtej linjave të konfliktit. Këto “rregulla të lojës ndëretnike” kanë krijuar kufi në thellësinë dhe gjerësinë e marrëdhënieve të cilat do të mund të zhvilloheshin me leje dhe kanë siguruar se çfarëdo angazhimi ndëretnik që ka ndodhur nuk do të sfidonte polarizimin e marrëdhënieve të shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës”<sup>66</sup>.*

Disa prej personave të intervistuar, kryesisht nga sektori i shoqërisë civile, por gjithashtu edhe nga sektori i biznesit, deklaruan se edhe ata vet i ndjejnë pasojat e presionit brenda komunitetit. Ata gjithashtu thanë se i janë nënshtruar reagimeve negative, frikësimeve, kërcënimeve e edhe sulmeve nga anëtarët e komunitetit të tyre sepse kishin bashkëpunuar me “tjerët”. Një aktivisti serb të Kosovës i angazhuar në bashkëpunimin ndëretnik i është thënë në rrugë, nga një grup serb, që të ketë kujdes për atë që ishte duke bërë, duke e kërcënuar me fjalët “mos të ndodhë të ta djeqim veturën”<sup>67</sup>

Një shqiptar i Kosovës, që jeton në pjesën veriore, e gjen vetën në mes dy anëve, pasi që bashkëpunon dhe ka miq në të dy anët e Ibrit, është emëruar “spiun serb” nga anëtarët e njërit komunitet, dhe është rrahur nga anëtarët e komunitetit tjetër<sup>68</sup>. Pa marrë parasysh këto përvoja frikësuese dhe kërcënimeve, njerëzit kishin vazhduar të punonin pasi që vërehet se besojnë në atë që po e bënin.

*“Nëse ke një cak dhe gjatë rrugës një qen fillon të lehtë, nëse do të kthehesh secilën herë ta frikësosh, nuk do të arrish të cakun asnjëherë. Nëse nacionalistët do të më duartrokisnin, atëherë diçka nuk është në rregull.”<sup>69</sup>*

Të mos luash sipas “rregullave të lojës ndëretnike”, siç bënë ky shqiptar i Kosovës, duhet pasur kurajo të cilën nuk e ka gjithkush. Zakonisht, presioni brenda komunitetit për t’iu nënshtruar rregullave të pashkruara rritet me ndjenjën e pasigurisë dhe nevojën e perceptuar për të mbrojtur “interesat e veta” duke “qëndruar së bashku” kundër “tjerëve”<sup>70</sup>.

#### *Ndërrimi i rregullave*

“Rregullat e lojës” i nënshtrohen ndryshimeve, varësisht prej rrethanave të jashtme, kryesisht zhvillimeve politike, por gjithashtu asaj se çka komuniteti e definojnë se është në interes të tij dhe cila sjellje merret si e pranueshme për t’i mbrojtur ato interesa. Për disa vite të fundit ka pasur ndryshime të ngadalshme të vazhdueshme, të cilat kanë zbutur kufizimet dhe kanë zgjeruar hapësirën e asaj që është e pranueshme në lidhje me bashkëpunimin ndëretnik. Jo vetëm që ishte më lehtë të bashkëpunohesh, qoftë në sektorin e shoqërisë civile ose në sektorin e biznesit, por edhe ishte më e lehtë të shoqërohesh në publik, të pini ndonjë kafe. Siç shpjegon një përfaqësues shqiptar i Kosovës nga një OJQ:

<sup>66</sup>CDA 2006, p. 28

<sup>67</sup> Intervistë me përfaqësues serb të Kosovës të OJQ-së, Mitrovicë, 26 tetor 2011

<sup>68</sup> Intervistë me përfaqësues shqiptar të Kosovës të OJQ-së, Mitrovicë, 11 nëntor 2011

<sup>69</sup> Intervistë me përfaqësues shqiptar të Kosovës të OJQ-së, Mitrovicë, 11 nëntor 2011

<sup>70</sup> Franović flet për “dilemën e sigurisë” që krijohet përmes proklamimit se bashkë-ekzistenca me “tjerët” nuk është e sigurt dhe ofrimit të zgjedhjeve që adresojnë vetëm “interesat tona” të cilat deklarohen se janë të kërcënuara nga “tjerët”. Prandaj etno-nacionalizmi është “makinë lëvizëse – e cila vazhdimisht e forcon vetën”. Franović 2008, f. 36f

*“Në të kaluarën, mendonim shumë se ku do të shkonim – duhej të shkonim në ndonjë vend që është i pranueshëm. Por tani kolegët [serb të Kosovës] e mi shkojnë edhe vet për kafe në jug e edhe flasin serbisht.”<sup>71</sup>*

Kryesisht shqiptarët e Kosovës besojnë se edhe nëse kanë pasur reagime negative në të kaluarën, pranimi i bashkëpunimit ndëretnik është rritur me kohë.

*“Ndonjëherë do të dëgjonim se komuniteti im thotë: ‘oh, ajo bashkëpunon me serb ose me rom’.*  
*Por kjo më nuk është e vështirë, kjo është bërë normale. Njerëzit tanimë e kanë pranuar këtë.”<sup>72</sup>*

Përderisa për shqiptarët e Kosovës dhe komunitet tjera “rregullat e lojës” janë relaksuar, presioni brenda komunitetit ka rënë e kjo vazhdon të jetë edhe pas ngritjes së barrikadave; për serbët e Kosovës, “rregullat e lojës” kanë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme, me 25 korrik 2011, duke kufizuar të gjitha bashkëveprimet, edhe ato që janë toleruar publikisht më herët. Ngritja e barrikadave është një shenjë e dukshme se si kalimi i linjave ndëretnike jo vetëm që nuk është i mirëseardhur, por ndalohet në mënyrë aktive për momentin. Në ballë të barrikadës që bllokoi një rrugë që shpie për në Lagjen e Boshnjakëve, nga pjesa veriore, është shkruar qëllimshëm: “Mos blini në Lagjen e Boshnjakëve”.

*“Para barrikadave, jo që punonim së bashku, por edhe uleshim së bashku në kafe, pinim së bashku pas biznesit, këtu në Mitrovicë ose në Prishtinë, kudo, serbët vinin këtu dhe unë shkoja atje. Është një mik i mirë i yni, e ka një kompani të mirë. Përveç që ka biznes të mirë, gjithashtu ka traditë në bërjen e rakisë të mirë.”\**

Ndryshimi i “rregullave të lojës” përcjell nevojën e perceptuar politike. Vendimi i 25 korrikut të vitit 2011 për të instaluar zyrtarët doganor të Kosovës në kufi me Serbinë në veri të Kosovës, luftohet fuqishëm jo vetëm nga serbët e Kosovës të atij zonë, por edhe nga politikanët në Serbi. Problemi i zyrtarëve doganor të Kosovës në dy pikat veriore është shndërruar në një luftë për mbijetesë të komunitetit serb në Kosovë (veriore). Serbët e

*“Për neve në pjesën jugore, është pak më lehtë, nuk e kemi atë presion të madh nga politikanët ose komuniteti që të punojmë a jo me komunitetet tjera. Përderisa për serbët është shumë më vështirë. Tash [bashkëpunimi ndëretnik] mund të bëhet në Lagjen e Boshnjakëve ose rrethet tjerat multietnike.”\*\**

Kosovës dhe politikanët dhe udhëheqësit serb thonë se serbët e mbetur të Kosovës janë në rrezik dhe refuzojnë çfarëdo bashkëpunimi me institucionet e Kosovës dhe organizatat ndërkombëtare që thuhet se i ndihmojnë ato institucione.

Kushdo që vazhdon bashkëpunimin me shqiptarët e Kosovës dhe/ose institucionet e Kosovës rrezikon të etiketohet si tradhtar pasi që supozohet se punon kundër

“interesave të serbëve të Kosovës”. Nëse dikush thyen rregullat, duhet të ketë frikë nga pasojat siç tregojnë disa shembuj që thuhet se kanë ndodhur: “Kam dëgjuar se një zonjë [serbe e Kosovës] është rrahur sepse kishte blerë në Lagjen e Boshnjakëve.”<sup>73</sup> Një grua tjetër serbe e Kosovës, e cila kishte vazhduar të shkonte në punë në Mitrovicë jugore, dhe e cila kalonte urën si më herët, është raportuar se gjithashtu është rrahur<sup>74</sup>.

<sup>71</sup> Intervistë me përfaqësues shqiptar të Kosovës të OJQ-së, Mitrovicë, 02 nëntor 2011

<sup>72</sup> Intervistë me përfaqësues shqiptar të Kosovës të OJQ-së, Mitrovicë, 02 nëntor 2011

\* Intervistë me biznesmen shqiptar të Kosovës, Mitrovicë, 31 tetor 2011

<sup>73</sup> Intervistë me përfaqësues shqiptar të Kosovës të OJQ-së, Mitrovicë, 26 tetor 2011

<sup>74</sup> Intervistë me zyrtar nga komuna e Mitrovicës me 19 tetor 2011

\*\* Intervistë me përfaqësues shqiptar të Kosovës të OJQ-së, Mitrovicë, 02 nëntor 2011

Shumica e partnerëve të intervistave kanë përmendur “rregullat e lojës” të ndërruara së fundi, dhe presionin e madh nën të cilin gjendet posaçërisht serbët e Kosovës, si një sfidë kryesore për bashkëpunimin ndëretnik për momentin dhe si një pengesë e mbajtjes së kontakteve, por edhe më shumë për krijimin e kontakteve tjera<sup>75</sup>.

*“[Serbët e Kosovës] tani kanë probleme brenda komunitetit të tyre, është një grup i serbëve që nuk i len njerëzit të bashkëpunojnë. Jam i sigurt se ka njerëz të cilët ende nuk e kalojnë urën sespe frikësoben se mund të ndodhë diçka.”<sup>76</sup>*

Serbët e Kosovës e pranojnë presionin e madh brenda komunitetit dhe ndikimin që e ka ai në bashkëpunim (potencial), por disa prej tyre kanë theksuar se besonin që këto tensione ekzistojnë në të dy anët. Mund të jetë që shqiptarët e Kosovës përjetojnë presion brenda komunitetit, por presioni në pjesën veriore është pakrahasueshëm më i lartë për momentin.

#### *Marrja me rregullat e lojës*

Mund të vërehen disa qasje për t’u marrë me presionin brenda komunitetit. “Fshehja” ose mbajtja e një profili të ulët duket se është një strategji e përcjellë nga serbët e Kosovës për të marrë dokumentet<sup>77</sup> e Kosovës ose për të bërë biznes “përtej linjave”. Partnerët e tyre ndihmojnë në mbajtjen e profilit të ulët, në mënyrë që të mos i sjellin vështirësi askujt. Për shembull, një biznesmen shqiptar i Kosovës nuk e reklamoi e as nuk i thotë askujt se edhe

*“Në situatë të tensionuar gjithmonë jemi shumë të kujdesshëm, jo për shkak timin personalisht, por ne jemi në kontakt edhe me kolegë dhe nuk dëshirojmë të lëndojmë ose shkaktojmë telashe, kur mund të funksionojë ndonjëherë edhe pa [kontakt personal].”\**

serbët e Kosovës janë myshterinj të tij; “nuk dëshirojmë ta provojmë fatin, që dikush të ketë probleme”<sup>78</sup>. Një përfaqësues i një OJQ-je që vepron në një zonë të përzier me personel dhe pjesëmarrës nga komunitetet e ndryshme mendon se mbajtja e profilit të ulët dhe mbajtja strikte e neutralitetit ndaj statusit është një strategji për të mbajtur presionin

brenda komunitetit në nivel të ulët<sup>79</sup>. Mos kalimi i urës aq shpesh sa e kanë bërë para se të ngritën barrikadat është një strategji tjetër e përcjellë nga të dy anët; kontakti personal është zëvendësuar përmes komunikimit me telefon, internet dhe video-konferencë. Disa OJQ dhe iniciativa kanë dy zyra, në veri dhe në jug të Ibrit, për të qenë lehtë të qasshme për anëtarët e komuniteteve në cilëndo pjesë dhe për të mos ekspozuar askënd ndaj ndonjë rreziku të lartë dhe për të ofruar aktivitete të pragut të ulët pasi që qëllimi është për të arritur edhe te ata të cilët mund të mos kalojnë urën.<sup>80</sup> Politika e dy zyrave është krijuar shumë më herët se barrikadat; njëra OJQ ka planifikuar të intensifikoj komunikimin, shkëmbimin personal dhe të udhëheq zyrat në të dy anët me personel të përzier si masë për të luftuar ndarjen. Për shkak të tensioneve të larta aktuale, kjo tani po implementohet më ngadalë<sup>81</sup>. Një strategji tjetër është takimi në vende të treta neutrale, qoftë në një shtet tjetër ose së paku larg vendin të rrethanave të përditshme. Kjo ishte një qasje e zakonshme në ditët e hershme të bashkëpunimit ndëretnik, por ende aplikohet, posaçërisht në fushat më sensitive siç janë organizimi i ndonjë ngjarje të përbashkët publike si për shembull Shkolla e

<sup>75</sup> Intervistë me përfaqësues shqiptar të Kosovës të OJQ-së, Mitrovicë, 11 nëntor 2011, me zyrtar shqiptar të Kosovës nga komuna e Kosovës në veri, me biznesmen serb të Kosovës, Kosovë veriore, 01 nëntor 2011

<sup>76</sup> Intervistë me përfaqësues shqiptar të Kosovës të OJQ-së, Mitrovicë, 02 nëntor 2011

<sup>77</sup> Intervistë me zyrtar shqiptar të Kosovës nga komuna e Kosovës në veri, 18 tetor 2011

<sup>78</sup> Intervistë me biznesmen shqiptar të Kosovës, Mitrovicë, 31 tetor 2011

<sup>79</sup> Intervistë me përfaqësues serb të Kosovës të OJQ-së, Mitrovicë, 24 tetor 2011

\* Intervistë me përfaqësues shqiptar të Kosovës të OJQ-së, Mitrovicë, 02 nëntor 2011

<sup>80</sup> Intervistë me përfaqësues shqiptar të Kosovës të OJQ-së, Mitrovicë, 02 nëntor 2011

<sup>81</sup> Intervistë me përfaqësues shqiptar të Kosovës të OJQ-së, Mitrovicë, 02 nëntor 2011

Rokut me anëtar të të gjitha komuniteteve duke luajtur së bashku. “Nuk mund ta mbajmë një koncert të madh në Mitrovicë sepse gjithmonë mund të eskaloj<sup>82</sup>”, është arsyeja për mbajtjen e punëtorive dhe koncerteve vjetore në Shkup.

Por në fund, shumica e këtyre aktiviteteve që zhvilloheshin më herët kanë vazhduar përkundër barrikadave; shumica e personelit dhe aktivistëve të OJQ-ve që kalonin urën më herët vazhdojnë ta bëjnë këtë. Barrikatat dhe presioni i madh brenda komunitetit kanë një ndikim të madh në bashkëpunimin biznesor dhe në intensifikimin dhe zgjerimin e planifikuar të aktiviteteve të OJQ-ve në fushën e bashkëpunimit ndëretnik.

### 4.3. Zona jote – Zona ime – Zona e përzier

#### *Mosekzistimi i anës tjetër*

Duke marrë parasysh se ekzistojnë vetëm disa zona të përziera në Mitrovicë dhe pjesën veriore të Kosovës dhe se në shumë raste infrastruktura të ndara tashmë janë vendosur si rezultat i ndarjes të “krijuar” pas luftës 98/99, mundësitë janë të kufizuara për t’u takuar “rastësisht”. Dikush duhet të bëjë njëmend përpjekje për të takuar anëtarët e komunitetit tjetër.

Anketa e UNDP-së në nëntor të vitit 2010 ka gjetur se brenda një periudhe tremujore, “një shumicë dërmuese e të anketuarve shqiptarë të Kosovës (73.6 përqind) kanë raportuar se nuk kanë kurrfarë kontakti me njerëzit nuk kanë përkatësi etnike shqiptare”<sup>83</sup> Serbët e Kosovës dhe anëtarët e komuniteteve tjera është raportuar se kanë më shumë kontakte ndëretnike, 42 dhe 48 përqind. Kontaktet mund të jenë krijuar duke qëndruar në veri ose jug të Ibrit me anëtar të komuniteteve tjera që jetojnë aty. Prandaj mund të thuhet se numri i atyre që kanë kaluar urën është edhe më i ulët. Disa partner të intervistave që jetojnë në Mitrovicë veriore vlerësojnë se 90 përqind e serbëve të Kosovës nuk e kanë kaluar asnjëherë urën në dymbëdhjetë vitet e fundit<sup>84</sup>. Sipas një përfaqësuesit të një OJQ-je:

*„Unë shkoj atje [Mitrovicë jugore] vetëm me punë dhe kaq. Nuk shkoj atje për të pirë kafe ose për shëtitje. Nuk ekziston. Ajo është vija që nuk e kalon. Nuk e vëren se ka diçka aty poshtë. I sheh ndërtesat, por nuk shkon atje dhe e merr si të tillë. Është çmenduri. Ndjenjë e çmendur mund t’ia u them.”\**

*“Shumica e njerëzve e përjetojnë urën si barrierë. Deri aty shkon, dhe pas asaj nuk ekziston asgjë më. Pas urës nuk ka asgjë. Një mik i imi nuk e ka kaluar urën që prej vitit 1999. Ai jeton gjatë gjithë kohës këtu në Mitrovicë, ani nuk ndjen nevojë, frikësohet, edhe sot, që të kaloj urën. E përveç atij, mendoj se ka një numër të madh të njerëzve të cilët nuk e kanë kaluar atë urë asnjëherë. Dhe pastaj kanë krijuar standarde të tilla që deri tek ura ka gjithçka, pas urës nuk ka asgjë.”<sup>85</sup>*

Ndjenja e mosekzistimit të anës tjetër në kuptim të veriut dhe jugut të Ibrit, është më shumë një fenomen i gjeneratave të reja të cilat nuk e kanë pasur rastin të përjetojnë Mitrovicën si një qytet të bashkuar, siç vëren një përfaqësues i një OJQ-je “ata në fakt nuk kanë miq në jug. Ata janë shumë të ri; ishte e ndarë atëherë”<sup>86</sup>.

Ndjenja që asgjë nuk ekziston në “anën tjetër” është një indikator i fortë se sa e ndarë është shoqëria, dhe si ndarja rrezikon të manifestohet brenda gjeneratave të reja që rriten me këtë

<sup>82</sup> Intervistë me përfaqësues shqiptar të Kosovës të OJQ-së, Mitrovicë, 02 nëntor 2011

<sup>83</sup> UNDP 2011, f. 47

<sup>84</sup> Intervistë me përfaqësues serb të Kosovës të OJQ-së, Mitrovicë, 28 tetor 2011, dhe me përfaqësues të OJQ-së në Mitrovicë veriore, 19 tetor 2011

<sup>85</sup> Intervistë me përfaqësues të OJQ-së në Mitrovicë veriore, 26 tetor 2011

\* Intervistë me përfaqësues të OJQ-së në Mitrovicë veriore, 19 tetor 2011

<sup>86</sup> Intervistë me përfaqësues të OJQ-së në Mitrovicë veriore, 19 tetor 2011

përvojë dhe me këtë akomodojnë vetëm brenda kufizimeve të komunitetit dhe zonës së tyre. Edhe për ata që kishin kontakte dhe miqësi para luftës të 98/99, takimi në person nuk është i zakonitë nëse duhet fizikisht të shkohet në “anën tjetër”, pa marrë parasysh a do të thotë kjo matanë urës ose ndonjë vend që është i banuar kryesisht nga një komunitet tjetër. Duket se ekziston një ndarje në “zonën time”, “zonën tënde” dhe një kuptim se kush ku e ka vendin.

#### *Faktorët që ushqejnë ndarjen*

Arsyet për “mos kalimin e kufijve” janë të shumta. Presioni brenda komunitetit dhe “rregullat e lojës ndër-etnike”, siç u theksua më lartë, luajnë një rol të rëndësishëm. Njëherë të vendosura dhe të respektuara, këto “rregulla” vështirë të tejkalohen, siç argumenton CDA: “Ka indikacione se ‘rregullat e lojës ndër-etnike’ janë përbrendësuar dhe vetë-zbatohen, duke reduktuar nevojën për forma më direkte të ‘frikësimit ndër-etnik’<sup>87</sup>. Vetë-kufizimi në lëvizje dhe kontakte, siç u përshkrua më lartë, është pasojë e këtij përbrendësimi.

Përvojat përgjatë dhe pas luftës së viteve 1998/99 dhe përleshjeve të dhunshme të vitit 2004, si dhe përvojat e përndjekjes dhe dhunës, janë arsytet thelbësore të ndarjes etnike, ndonëse vetëm një pakicë e të intervistuarve ka përmendur këto arsye në mënyrë eksplicite<sup>88</sup>. Për serbët e Kosovës, trazirat e marsit të vitit 2004 janë arsye e fuqishme për mosbesim dhe frikë, siç e shpjegon një aktivist.

*“Pas kësaj (dhunës së vitit 2004) njerëzit këtu kuptuan ‘ok, askush nuk mund të na mbrojë (...). Ky është mosbesim 200 për qind. Ata nuk besojnë – Nëna Tereze mund të ngrihet nga varri dhe të thotë ‘njerëz, askush nuk do t’ju bëjë keq’. Jo.”<sup>89</sup>*

Në një mënyrë ose në një tjetër, anëtarët e të gjitha komuniteteve ishin objekt i sulmeve, dhunës dhe përndjekjes gjatë konfliktit të viteve 1998/1999 ose më pas. Kjo nuk do të duhej të shërbente si arsye për dhunë kundër askujt, por mund të shpjegojë nivelin e lartë të mosbesimit dhe ndenjen e të qenit i pasigurt në “zonën e tjetrit”.

*„Nga frika ata kanë humbur interesimin duke thënë ‘Çfarë do të kërkoja unë atje? Në qoftë se do të më duhet të mendoj nëse dikush atje do të më rrahë ose, mos e dhëntë Zoti, të më vrasë – atëherë pse duhet të shkoj unë atje?’“\**

Frika dhe mosbesimi janë përmendur disa herë si pengesa të fuqishme për të vendosur kontakte ndër-etnike; frika se çfarë do të mund të ishte reagimi i komunitetit të vetë personit për mosrespektimin e

“rregullave të lojës” por edhe frika nga reagimi i anëtarëve të komunitetit tjetër në momentin e takimit me ta. Kjo frikë përgjithësisht është karakterizuar si frikë nga e panjohura, e bazuar në paragjykimet që ushqehen nga propaganda dhe keqinformimi, që është ndjenjë që ndahet nga të gjithë sektorët dhe të gjitha komunitetet<sup>90</sup>.

Të rinjtë janë konsideruar të jenë në mënyrë të veçantë të lëndueshëm ndaj keqinformimit dhe krijimit të paragjykimeve të forta, sepse ata nuk kanë ndonjë përvojë të tyre personale të kontakteve ndër-etnike, por bazohen në informacionin e marrë nga media, siç shpjegon një përfaqësues i një OJQ-je, shqiptar i Kosovës:

<sup>87</sup> Intervistë me një përfaqësues të një OJQ-je me seli në Mitrovicën e veriut, 19 tetor 2011

<sup>88</sup> Intervistë me një përfaqësues të një OJQ-je me seli në Mitrovicën e veriut, 26 tetor 2011, me përfaqësues të OJQ-së, shqiptar i Kosovës, 2 nëntor 2011

<sup>89</sup> Intervistë me një përfaqësues të një OJQ-je me seli në Mitrovicën e veriut, 26 tetor 2011

\* Intervistë me një përfaqësues të një OJQ-je me seli në Mitrovicën e veriut, 26 tetor 2011

<sup>90</sup> Intervistë me përfaqësues të një OJQ-je, shqiptar i Kosovës, Mitrovicë, 11 nëntor 2011, me përfaqësues të OJQ-së, shqiptar i Kosovës, Mitrovicë, 2 nëntor 2011, me përfaqësues të OJQ-së në Mitrovicë, 19 tetor 2011, me një biznesmen serb, Kosovë veriore, 1 nëntor 2011

*”Ndoshta (personat e vjetër) nuk kanë pasur kontakte në 10 vitet e fundit, por nëse ata takohen, ata e njohin njëri-tjetrin nga më parë dhe e dinë se nuk do t’i bëjnë keq njëri tjetrit ose se diçka e keqe mund të ndodhë. Por me të rinjtë është ndryshe, është më vështirë. Secila nga palët rriten pranë televizorit, mediave dhe kështu mendojnë se në anën tjetër të gjithë janë ekstremistë.”<sup>91</sup>*

Sa më shumë kalon koha, aq më shumë komunitetet rrinë në zonën e tyre dhe më shumë të rinj nuk kanë përvojë tjetër përveç ndarjes, sa më shumë që vetë-kufizimi në lëvizje dhe kontakte konsiderohet diçka normale, aq më e vështirë do të jetë për të tejkaluar këto stereotipe dhe këtë mosbesim (të përbrendësuar), veçanërisht nëse mediat vazhdojnë të sforcojnë paragjykimet.

### *Tejkalimi i ndarjes*

Rinia identifikohet si një target grup i rëndësishëm nga shumë OJQ. Gama e aktiviteteve që i adresohen të rinjve është e gjerë: një OJQ u ofron grupeve të fëmijëve në zonat e përziera të institucionalizojnë mundësitë e hapësirës ndër-etnike dhe të krijojnë ambient të sigurt për takime dhe interaksion me anëtarët e komuniteteve tjera<sup>92</sup>. Organizatat tjera i bëjnë bashkë të rinjtë në ekskursione ose ngjarje të përbashkëta për të vendosur kontaktin e parë dhe për t’ju ofruar një përvojë shtesë. Disa aktivitete afatgjate organizohen në dy lokacione të ndryshme, me takime dhe aktivitete të përbashkëta herë pas here. Ndarja e informacionit është pjesë e strategjisë në adresimin e të rinjve dhe popullatës së përgjithshme për të tejkaluar paragjykimet.

*„Mendoj se një numër I madh (i të rinjve) janë të frikësuar. Ata kanë paragjyqime lidhur me jugun ose veriun – se në veri jetojnë vetëm çetnikë dhe se në jug jetojnë vetëm njerëz të UCK-se. Thjesht, të rinjtë krijojnë një përshtypje të gabuar duke shikuar TV dhe media tjera”<sup>93</sup>*

Disa organizata<sup>93</sup> janë duke e implementuar së bashku projektin e quajtur “Tejkalimi i ndarjes” (Bridging the Divide) i cili përfshin po ashtu një komponent medial<sup>94</sup> – një ueb faqe dhe revistë të shtypur me informacione nga të gjitha anët, të shkruar nga gazetarë të komuniteteve të ndryshme, serbë të Kosovës, shqiptarë të Kosovës dhe boshnjakë. Ofrimi i informacionit nga të dyja anët, adresimi i çështjeve të përbashkëta si furnizimi me energji elektrike, kriminaliteti ose papunësia, por edhe zhvillimet politike, do të krijojë një bazë për mirëkuptim të dyanshëm, do të luftojë paragjykimet dhe do të afrojë komunitetet me njëra tjetrën. Strategjia kryesore e aplikuar nga shumica e OJQ-ve në veri të Kosovës për të përmbushur zbrazësinë dhe shkatërruar paragjykimet është vendosja e kontaktit direkt dhe bërja bashkë e njerëzve nga komunitetet e ndryshme. Në disa raste, kontakti personal përcillet me kontakte tjera përmes mediave sociale.

Nga përvoja e tyre, shumica e partnerëve të intervistuar janë bindur për vlerën e lartë që kanë kontaktet personale në tejkalimin e paragjyqimeve dhe ndryshimin e perceptimit, siç e përshkruan një shqiptar i Kosovës përvojën e tij kur kishte shkuar në një restorant në veri:

*“Me kohë i kam tejkaluar (paragjykimet e mia). Një nga paragjykimet e mia për shembull ka qenë se nëse më dëgjojnë duke folur shqip, do të më rrabin. Por, ndërsa po drekoja në një restorant serb në veri dhe porosita ushqim - ndërkohë bisedoja me disa kolegë në shqip – kamerieri më foli*

<sup>91</sup> Intervistë me përfaqësues të një OJQ-je, shqiptar i Kosovës, Mitrovicë, 02 nëntor 2011,

<sup>92</sup> Intervistë me një përfaqësues të një OJQ-je, serb i Kosovës, Mitrovicë, 24 tetor 2011

<sup>93</sup> CBM si OJQ kryesore në bashkëpunim me koalicionin CRYM që përfshin shtatë OJQ dhe iniciativa

<sup>94</sup> “Bridging the Divide“ përbëhet prej tri komponentëve, komponentit medial, infrastrukturës dhe koalicionit CRYM për të fuqizuar sektorin e shoqërisë civile në veri.

*shqip, disa fjalë. Kështu që kur njerëzit i përjetojnë disa situata në lekurën e tyre, ata do t'i ndryshojnë paragjykimet, mendimet. Por nëse janë të fokusuar në thashetheme, duke dëgjuar fjalë, poshtë në qytet ose në mediat kombëtare të cilat janë të anshme, ata definitivisht do të mbeten brenda kutisë dhe jo jashtë kutisë, për një kohë të gjatë”<sup>95</sup>*

Disa raste janë përmendur kur stafi i OJQ-ve ose të tjerët të përfshirë në bashkëpunim ndër-etnik kanë përjetuar reagime negative ose frikësim nga anëtarët e komunitetit tjetër. Partnerët e intervistuar më shpesh kanë thënë se ‘asgjë nuk ka ndodhur’ ose kanë folur për reagimet pozitive të cilat ishin befasuese dhe inkurajuese për ta. Një biznesmen kishte patur përvoja të ngjashme; një biznesmen serb i Kosovës u ndje mjaft shumë i inkurajuar nga trajtimi akomodues që kishte përjetuar në kontaktet me institucionet e Kosovës<sup>96</sup>.

Partnerët e intervistuar që janë të përfshirë drejtpërdrejt në bashkëpunimin ndër-etnik i kujtuan hapat e parë si mjaft të vështirë pasi që nuk e dinin se si do të pranoheshin ata dhe projektet e tyre. Megjithatë, besimi mendohet se luan një rol të rëndësishëm në këto projekte. Besimi në organizatën, në qëllimet, në kuptim të asaj që qëllimet nuk duhet të jenë të asaj natyre ku, për shembull, serbët e Kosovës do të mund të mendonin se një projekt i caktuar ka një ‘agjendë të fshehur’ për të instaluar institucionet e Kosovës në veri. Kjo vlen edhe për donatorët gjithashtu..

Një përfaqësues i një OJQ-je, shqiptar i Kosovës, që menaxhon një qendër në një lagje të përzier bashkë me një organizatë të serbëve të Kosovës shpjegoi se në fillim “*kishte disa vështirësi, por ne vazhduam dhe e arritëm këtë respekt nga të gjitha komunitetet. Sepse të gjithë e kujtuan se ne punojmë për të mirën e të gjitha komuniteteve”<sup>97</sup>.*

Përvoja vetanake dhe kontaktet personale janë elemente të rëndësishme për të tejkaluar ndasitë dhe krijimin e besimit. Rëndësia e kësaj ndërmarrje, të vështirë në shikim të parë, për të bërë bashkë njerëzit nuk duhet të nën-vlerësohet. Shembujt pozitiv nga komunikimi ndër-etnik mund të luajnë një rol të rëndësishëm në ‘përmirësimin’ e imazhit të palës tjetër i cili shpesh portretizohet me nënkuptime negative. Sidoqoftë, vendosja e besimit mes komuniteteve në një nivel më të gjerë nuk mund të mbështetet vetëm në kontakte personale por duhet të ndihmohet nga të gjitha nivelet e shoqërisë, përfshirë mediat dhe politikën.

#### *Ndjenjat e pakëndshme në Zonën Tjetër*

Vetëm pak njerëz duket të ndjehen po aq rehat në ‘zonën tjetër’ sa në zonën e tyre. Kjo është më tepër një ndjenjë e përgjithshme, që nuk ndërlihet e tensionet e fundit. Shumica e personave të intervistuar deklaruan se ata ndjehen disi jokomod kur gjenden në ‘anën tjetër’, dhe gjithmonë kanë një dozë frike dhe ‘asnjëherë nuk ndjehen të lirë’<sup>98</sup>. Ka edhe nga ata që me gjithë përvojat pozitive që kanë pasur kur gjenden në ‘anën tjetër’ vazhdojnë t’i kenë ato ndjenja, sic e pranon një serb i Kosovës:

*“Kjo është një farë frike e ndërrijshme. Isba në Prishtinë, hyra me një lokal, përsëndeta në anglisht ‘mirëdita’ dhe vajza mu përgjigj: ‘dobar dan, izpolite’ (serbisht: mirëdita, urdhëroni). Pa asnjë problem. Sepse ajo e pa që unë nuk jam i huaj. Pastaj ulesh në kafene, bisedon me njerëz*

<sup>95</sup> Intervistë me përfaqësues të një OJQ-je, shqiptar i Kosovës, Mitrovicë, 26 tetor 2011

<sup>96</sup> Intervistë me një biznesmen serb, Kosovë e veriut, 01 nëntor 2011

<sup>\*\*</sup> Intervistë me një përfaqësues të një OJQ-je, serb i Kosovës, Mitrovicë, 26 tetor 2011

<sup>97</sup> Intervistë me përfaqësues të një OJQ-je, shqiptar i Kosovës, Mitrovicë, 02 nëntor 2011

<sup>98</sup> Intervistë me një përfaqësues të një OJQ-je, serb i Kosovës, Mitrovicë, 28 tetor 2011



*dhe kur e kthen kokën vëren se si dikush t'i ka ngulur sytë. Të shikon dhe ti nuk ndjehesh rehat. Ndoshhta shikon sepse i pëlqejnë koleget e mia, por mendja gjithmonë të shkon për keq.”<sup>99</sup>*

Shumë njerëz kur shkojnë në ‘zonën tjetër’ nuk lëvizin vetëm por zakonisht përcillen nga dikush që jeton në ‘zonën tjetër’ të cilin ata e njohin.<sup>100</sup> Shpesh ata që bëhen nikoqirë të njerëzve nga ‘ana tjetër’ ndjehen ‘përgjegjës’ për sigurinë e ‘mysafirëve’ të tyre. Masa sigurie të kujdesit si ndërrimi i targave të makinës, targat e Kosovës në jug, targat e Serbisë në pjesën veriore, janë rutinë.

#### *Zonat e përziera*

Lokacioni ku ndodh bashkëpunimi ndër-etnik është shumë i rëndësishëm. Takimi në Lagjen e Boshnjakëve, e cila paraqet njëfarë mënyrë një vend ‘neutral’ ose ‘tampon zonë’, është më i lehtë. Kjo lagje gjendet në Mitrovicën veriore, por duke qenë se ka një popullatë të përzier, në njëfarë mënyrë, nuk konsiderohet ‘njëmend’ as jug as veri. Të gjitha gjuhët mund të dëgjohen në këtë lagje, shenjat në dyqane janë zakonisht në shqip dhe serbisht. Pozita e të qenit zonë as e ‘imja’ as e ‘jotja’, e të qenit në mes, ua lehtëson komunitetit serb dhe komunitetit shqiptar qasjen në këtë zonë – ajo nuk paraqet pra ‘zonën e tjetrit’ por më shumë një vend të tretë. Dy organizata/iniciativa multi-etnike<sup>101</sup> veprojnë në lagje. Në përfundim të lagjes së Boshnjakëve, në anën tjetër të urës, në pjesën jugore, së voni është hapur një hipermarket ndërsa një tjetër do të hapet së shpejti. Lokacioni me gjasë nuk është rastësi, sepse ato synojnë të tërheqin konsumatorë nga të dyja anët e Ibrit.

Një tjetër lagje e përzier në Mitrovicë është ajo e Kodrës së Minatorëve, e cila është qartazi në pjesën veriore dhe një lagje krejtësisht rezidenciale për dallim nga ‘zona tregtare’ e Lagjes së Boshnjakëve. Serbë, shqiptarë, turq dhe boshnjakë të Kosovës jetojnë atje pa ndarje të brendshme<sup>102</sup>. Fëmijët e kësaj lagje rriten në ambient multi-etnik duke luajtur futboll së bashku. Siç e tha një banor turk:

*“Këtu është e përzier, nuk ka ndarje. Ajo është e respektuar, ai është i respektuar, kështu ne jetojmë. Si në familje, kur jeton me vjehrrën. Ajo mund të ketë tjetër mendim por ti e respekton atë dhe ajo të respekton ty, kështu që mund të jetoni së bashku. Njësoj ndodh edhe në lagje – ju e respektoni dhe i besoni njëri-tjetrit, kjo është shoqëria”<sup>103</sup>*

Një qendër grash e themeluar atje nga një OJQ disa vite më parë<sup>104</sup>, me gjasë ka kontribuar në krijimin e stabilitetit duke tërhequr 60 deri në 100 gra si anëtare të rregullta të cilat nuk e kishin njohur njëra tjetrën më herët. Jo të gjithë banorët që jetojnë në këtë lagje kishin jetuar aty para konfliktit të vitit 1998/1999; shume serbë të Kosovës janë vendosur këtu nga vende të tjera të Kosovës. Që nga themelimi i qendrës së grave, “problemet ndër-etnike në mes të komuniteteve në lagje janë zvogëluar ndjeshëm”<sup>105</sup> vlerëson një përfaqësues i OJQ-së që menaxhon qendrën.

‘Lokacioni i duhur’ është i një rëndësie të madhe për komunikimin ndër-etnik. Zonat e përziera mund të ofrojnë një ambient përkrahës ku anëtarët e komuniteteve të ndryshme ndjehen komod për të lëvizur lirshëm dhe për t’u takuar. Këto zona të përziera jo vetëm që

<sup>99</sup> Intervistë me përfaqësues OJQ-je me seli në veri të Mitrovicës, 26 tetor 2011

<sup>100</sup> Intervistë me përfaqësues të një OJQ-je, shqiptar i Kosovës, Mitrovicë, 02 nëntor 2011

<sup>101</sup> Caritas dhe Qendra për Komunitete, Biznes dhe Rini – kjo qendër menaxhohet bashkërisht nga dy OJQ: Mundësia nga Mitrovica jugore dhe Shoqata Afariste e Grave nga Mitrovica veriore.

<sup>102</sup> Intervistë me banorë serb dhe turk të Kosovës të kësaj lagje, 11 nëntor 2011

<sup>103</sup> Banor turk, intervistë 11 nëntor 2011

<sup>104</sup> Në kohën e shkrimit të këtij raport, qendra nuk ishte funksionale, por planifikohej të rihapej.

<sup>105</sup> Intervistë me përfaqësues të një OJQ-je, shqiptar i Kosovës, Mitrovicë, 02 nëntor 2011

janë të rëndësishme për njerëzit që jetojnë aty, por, siç tregon rasti i Lagjes së Boshnjakëve, mund të tërheqin njerëz dhe biznese nga zonat tjera, duke ndihmuar kështu në zbehjen e vijave të ndarjes dhe duke rritur ngadalë ‘zonën e përzier’.

#### 4.4 Më shumë se përkatësi etnike

*Bashkëpunimi ndër-etnik – domosdoshmëri?*

Ideja e bashkëpunimit vetëm për hir të implementimit të disa projekteve ndër-etnike është kritikuar dhe refuzuar. Shumica pajtohen se detyrimi i njerëzve në bashkëpunim nuk do të rezultojë në marrëdhënie të qëndrueshme ndër-etnike. Një aktivist i një OJQ-je ankohet se si donatorët të cilët financojnë projektet kërkojnë që ‘është shumë e rëndësishme që në raport të shkruhet se kanë qenë 25 shqiptarë dhe 25 serbë dhe se ata kanë bërë diçka së bashku; pa marrë parasysh çfarë’<sup>106</sup>

Po ashtu, janë kritikuar edhe ngjarjet me një aktivitet dhe projektet afatshkurtra që nuk kanë pasur një aktivitet pasues që do të ndërtonin mbi kontaktet e vendosura më parë. Ndryshe, thotë një aktivist i një OJQ kjo do të ishte:

*“[...] pastrim parash dhe bedhje parash. Sepse secili nga këto projekte ose është grup fokusi, debat ose seminar – dhe pastaj ne nuk komunikojmë më. Projektet nuk janë të qëndrueshme, nuk ka rezultate. Ka vetëm rezultate imediate, siç janë raportet, kush çfarë tha. Por ne nuk kemi nevojë të dimë se kush çfarë tha; ne kemi nevojë për ndikim direkt në jetë.”<sup>107</sup>*

Një pasqyrë e brendshme e KIPRED-it mbi aktivitetet e dy viteve të fundit tregon se një numër i madh aktivitetesh ishin projekte me një aktivitet (një ngjarje) ose projekte afatshkurtra si trajnime, punëtori, ligjërata, kryesisht të implementuar nga OJQ që nuk kanë implementuar projekte tjera ndër-etnike më parë. Disa përfaqësues OJQ-sh ishin shumë kritikues ndaj aktiviteteve ndër-etnike që ata besonin se ishin artificiale dhe nuk kishin kurrfarë ndikimi në shoqëri. Këto projekte shpesh nuk kishin asfare ndërlidhje reale me komunitetin dhe as do t’i shërbenin nevojave, shqetësimeve dhe prioriteteve të komunitetit<sup>108</sup>.

Shumica e të intervistuarve megjithatë nuk ishin kritikues ndaj bashkëpunimit ndër-etnik në vetvete. Ata më shumë vënin në pikëpyetje qasjen, duke kërkuar që të mos bëhen aktivitete vetëm për hir të organizimit të takimeve mes anëtarëve të komuniteteve të ndryshme, në qoftë se nuk kishte ndonjë interes tjetër të përbashkët

*Qasja e bazuar në interes*

Bashkëpunimi ndër-etnik duhet të bazohet në nevojat e përbashkëta dhe interesat. Nëse të dy palët kanë një interes, atëherë njerëzit edhe do të takohen, bashkëpunojnë, vendosin marrëdhënie – kjo është bindja e përgjithshme dhe përvoja e disa OJQ-ve që kanë punuar në këtë fushë. Sipas shumë përfaqësuesve të OJQ-ve, qasja e bazuar në interes është

*“Kombësitë nuk janë të rëndësishme por vlerat e përbashkëta dhe interesat e përbashkët.”\**

kruciale Kjo i referohet çështjeve me të cilat këto projekte merren por edhe qasjes që projektet kanë në implementim, për shembull, bashkërisht, apo në dy lokacione. Vetëm duke adresuar nevojat dhe interesat, dhe jo duke

‘detyruar’ bashkëpunimin ndër-etnik si kusht për aprovimin e një projekti, mund të zgjidhet interesimi i vërtetë për kontaktuar dhe komunikuar me anëtarët e komunitetet tjetër. Kjo

<sup>106</sup> Intervistë me përfaqësues OJQ-je me seli në veri të Mitrovicës, 26 tetor 2011

<sup>107</sup> Intervistë me një përfaqësues të një OJQ-je, serb i Kosovës, Mitrovicë, 28 tetor 2011

<sup>108</sup> Intervistë me një përfaqësues të një OJQ-je, serb i Kosovës, Mitrovicë, 28 tetor 2011

çmohet si bazë e marrëdhënieve të qëndrueshme. Të rinjtë që janë të përfshirë në një program që zbatohet në të dy anët e Ibrit “*takojnë njëri tjetrin edhe së voni. Ata kanë filluar të ftojnë njëri-tjetrin në jug ose në veri, edhe pa na pyetur neve, gjë që është e mirë*”<sup>109</sup>. Koncentrimi në nevojat lokale ndërkohë që jeni i hapur parimisht ndaj secilit është qasja e një tjetër OJQ-je që vepron në Mitrovicën e jugut. Kjo OJQ ofron aktivitete artistike kryesisht për të rinj. Qëllimi kryesor nuk është të vendoset bashkëpunimi ndër-etnik por tërheqja e njerëzve të cilët ndajnë interesimet e njëjta, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike.

Qasja e bazuar në interes përdoret në rastet e përmendura më parë kur serbët e Kosovës shkojnë në fshatrat shqiptare për të aplikuar për dokumente identifikuese të Kosovës në mënyrë që të marrin pensionin. Njësoj, fëmijët romë që jetojnë në Mëhallën e Romëve në jug të Ibrit shkojnë në shkollë në pjesën veriore, duke ilustruar kështu funksionimin e qasjes së bazuar në interes. Shumë fëmijë janë regjistruar në shkollë në kohën kur ende jetonin në kampe në Mitrovicën e veriut. Ata vazhduan të shkonin në shkollë atje, vëllezërit dhe motrat e reja vazhduan pas tyre. Një arsye tjetër pse shumica e fëmijëve romë shkojnë në shkollat e administruara nga Serbia në pjesën veriore është përfitimi financiar që paguhet për nxënësit nga institucionet e Serbisë<sup>110</sup>.

*Me interes të veçantë: ekonomia, biznesi, tregtia, punësimi*

Shumë raporte, si ai i UNDP-së, por edhe përshtypjet e marra nga njerëzit në pjesën veriore të Kosovës theksojnë papunësinë dhe gjendjen e përgjithshme ekonomike si brengën kryesore<sup>111</sup>. Aktivitetet ekonomike janë pjesë e rëndësishme e qasjes së bazuar në interes, jo vetëm sepse në një mënyrë i zbusin vijat ndarëse, që zakonisht janë shumë strikte. Punëtorët shqiptarë shkojnë në vendpunishte në Pjesën veriore të Kosovës për të punuar për serbët, siç bëjnë romët duke punuar si argat dite në Mitrovicën e veriut. Të gjithë ndërmarrësit e intervistuar kanë deklaruar se biznesi funksionon vetëm kur bazohet në një interes. Ata thanë se nuk ju intereson përkatësia etnike e dikujt, por biznesi, profiti, zhvillimi ekonomik dhe bashkëpunimi.

Zhvillimi ekonomik dhe krijimi i vendeve të punës do të kishin një ndikim pozitiv të madh në relacionet ndër-etnike. Ky ishte opinionin jo vetëm i biznesmenëve por edhe i përfaqësuesve të OJQ-ve dhe personave tjerë të intervistuar.

*“Mua më intereson vetëm profiti në biznes. Nuk më intereson nëse dikush shkon në kishë apo xhami, por se ai do ta kryejë punën e tij.”\*\**

Disa OJQ punojnë në sektorin e zhvillimit ekonomik dhe gjenerimit të të ardhurave. Njëra që implementon një projekt që punëson 200 punëtorë të komuniteteve të ndryshme ka konstatuar se punëtorët jo vetëm që punojnë në grupe të përziera pa asnjë problem, por “*ata, edhe privatisht, pas pune, rrinë bashkë, shkojnë në kafene bashkë, flasin serbisht edhe në pjesën jugore (të Mitrovicës), gjë që është e jashtëzakonshme*”<sup>112</sup>

Është vështirë të vlerësohet i gjithë interaksioni në mes të anëtarëve të komuniteteve të ndryshme bazuar vetëm në interesin personal, siç është kërkesa për pajisje me dokumente të Kosovës, ose relacionet afariste ose tregtare, sepse ato shpeshherë vetë-iniciohen, janë sporadike dhe të natyrës private.

Gjetjet mbështesin supozimin se ekzistimi i një interesi dhe përfitimi të përbashkët mund të jetë mjaftueshëm i fuqishëm për të tërhequr njerëz nga komunitetet e ndryshme dhe për t'i

<sup>109</sup> Intervistë me përfaqësues të një OJQ-je, shqiptar i Kosovës, Mitrovicë, 02 nëntor 2011

\* Intervistë me përfaqësues të një OJQ-je, shqiptar i Kosovës, Mitrovicë, 13 dhjetor 2011

<sup>110</sup> Intervistë me përfaqësues rom të OJQ-së, 25 tetor 2011

<sup>111</sup> UNDP 2011, f. 15

<sup>112</sup> Intervistë me përfaqësues të një OJQ-je, shqiptar i Kosovës, Mitrovicë, 02 nëntor 2011

inkurajuar ata që të 'tejkalojnë vijat etnike'. Megjithatë, në kohën e tensioneve të larta dhe presionit brenda komunitar, duhet më shumë kurajë për të vendosur dhe ruajtur kontaktet ndër-etnike; interesimi për të qëndruar në 'anën e sigurt' brenda komunitetit të vet shpesh perceptohet të jetë më i lartë se sa dëshira për bashkëpunim dhe për thyerje të 'rregullave të lojës'.

*Përkatësia etnike nuk është gjithçka*

Kur kemi të bëjmë me kooperim, marrëdhënie dhe pajtim ndëretnik, përkatësia etnike është kategoria kyçe. Megjithatë, disa partnerë intervistues vërejtën se ata dëshironin që kombësia do të bëhej e parëndësishme, se përcaktimi i përkatësisë etnike të një personi si një kategori e rëndësishme do të bëhet e vjetërsuar dhe se jo çdo gjë do të shikohet përmes lenteve të marrëdhënieve etnike/ndëretnike<sup>113</sup>.

Disa OJQ punojnë sipas kësaj qasjeje dhe nuk e cilësojnë etninë si kategorinë e vetme më të rëndësishme, nuk krijojnë 'kuota'. *"Në të kaluarën, duhej të kishim gjithmonë staf proporcional nga jugu dhe nga veriu. Ne ende nuk dëshirojmë të humbim këtë bilanc, pra të kemi shumë shqiptarë e asnjë serbë, por më nuk e shohim atë si një përqindje 60:40, apo 50:50 – kjo varet nga ajo se sa të mirë janë personat që aplikojnë për një punë"*.<sup>114</sup> Një qasje e ngjashme përcillet nga një OJQ tjetër e cila përqendrohet në fuqizimin e gruas, *"por pa dallime se cilës kombësi i përkasin"*.<sup>115</sup>

Në studimin e saj të rastin mbi pajtimin në Ballkanin Perëndimor, Franović pretendon se:

*"Aktivistët e paqes nuk duhet të përqendrohen në etninë, por në strukturat, kulturat dhe ideologjitë që janë bazë për konflikte të dhunshme. Ata duhet tu japin njerëzve hapësirë për të pushuar nga etiketimi i lodhshëm dhe me presion i etnisë, dhe duhet tu ofrojnë atyre mënyra tjera për ta perceptuar realitetin dhe të veprojnë"*.<sup>116</sup>

Ky është njëri prej synimeve të një reviste të Mitrovicës/Mitrovica e botuar në tri gjuhë, m-magazine: që të shkruajnë mbi çështje jashtë konfliktit dhe ndarjes ndëretnike e cila është temë e zakonshme përmes së cilës Mitrovica/Mitrovica shfaqet në lajme. Artikujt nuk do të nënshkruhen nga vetëm një person por kolektivisht si m-magazine në mënyrë që t'i shmangen gjykimeve të përmbajtjes së artikullit që i bëhen në baza të prejardhjeve etnike të gazetarëve<sup>117</sup>.

Natyrisht se prejardhja etnike do të luaj edhe më tutje një rol të rëndësishëm, por nuk do të duhej të ishte e vetmja kategori dhe një qasje më relaksuese ndaj saj do të ndihmojë që të tejkalohej kategorizimet e ndasive etnike. Kufizimi i njerëzve në përkatësitë e tyre etnike vetëm sa do të humbiste qëllimin dhe do të vinte në pah shumëllojshmëritë dhe mendimet e ndryshme përbrenda komuniteteve dhe shoqërisë në përgjithësi. Ajo do t'i detyronte gjithashtu njerëzit që të anojnë kur të përqendrohen vetëm në definicionet etnike. Mospërqendrimi vetëm në përkatësitë etnike nuk nënkupton medoemos favorizimin ndaj qasjes "ne të gjithë jemi të barabartë" ndërsa përfshin diskriminimin strukturor dhe përjashtimet sociale.

---

<sup>113</sup> Intervistë me përfaqësues shqiptar të Kosovës të OJQ-së, Mitrovicë/Mitrovica, 13 dhjetor 2011

<sup>114</sup> Intervistë me përfaqësues shqiptar të Kosovës të OJQ-së, Mitrovicë/Mitrovica, 02 nëntor 2011

<sup>115</sup> Intervistë me përfaqësues shqiptar të Kosovës të OJQ-së, Mitrovicë/Mitrovica, 02 nëntor 2011

\*\* Intervistë me afarist serb të Kosovës, veriu i Kosovës, 01 dhjetor 2011

<sup>116</sup> Franovic 2008, f. 24

<sup>117</sup> Intervistë me përfaqësues shqiptar të Kosovës të OJQ-së, Mitrovicë/Mitrovica, 26 tetor 2011

Disa OJQ përqendrohen vetëm tek një komunitet. Organizata tjera që ofrojnë aktivitete ndëretnike, pjesë të programeve të tyre drejtohen ndaj vetëm një komuniteti ose bashkëpunojnë vetëm në fusha specifike me organizata dhe komunitete. Puna brenda-komunitetit nuk konkurrencë me bashkëpunimin ndëretnik apo pengesë për të. Ato OJQ që kanë vendosur të përqendrohen vetëm në një komunitet e shohin këtë si hapin e parë dhe një parakusht për kontakte të ardhshme ndëretnike. Një përfaqësuese serbe thotë se në veçanti, serbët dhe shqiptarët e Kosovës do të jetonin në kushte të ndryshme, në situata të ndryshme me struktura të ndryshme dhe nevojat e komunitetit – apo grupe të mëdha të komuniteteve. Ajo karakterizon komunitetin shqiptar – duke iu referuar të rinjve – si “shoqëri progresive”, ndërsa shoqëria e serbëve të Kosovës ishte “regresive”, “intelektualist, në numra dhe kulturalisht. *Atëherë si mund të krijonë qasjen e njëjtë? Duhet të përcaktoni një synim të përbashkët, mirëpo qasje asimetrike*”<sup>118</sup>. Puna brenda-komunitetit është parë si një fazë për stabilizim dhe përgatitje, duke iu adresuar “*shumicës së re dhe të dhunshme. Duhet të punojmë me ta. Interesi im nuk është që të bisedoj me popullatën e re të cilët janë të mirë – ata janë të pakët.*”<sup>119</sup>

Një përfaqësues tjetër i një OJQ-je, e angazhuar në punën brenda-komunitetit, veçanërisht në aktivitetet që përqendrohen në interesa specifik dhe jo në prejardhjet etnike, thotë se “*njerëzit duhet të ndjehen rehat në jetën e tyre dhe aty ku jetojnë. Atëherë ata do të jenë më kureshtarë për të parë diçka tjetër, e cila do të vinte di një proces natyral. Nëse ndjehen të frustruar apo të pakënaqur, si mund të kërkonin prej tij që të takohet me dikë tjetër që gjithashtu është i frustruar dhe i pakënaqur?*”<sup>120</sup>

Në nivel të OJQ-ve, shumica e përfaqësuesve takohen përgjatë vijave etnike dhe kooperojnë dhe komunikojnë, por jo medoemos pjesëmarrësit e aktiviteteve. Kjo nuk duhet të shihet si kontradiktë ndaj ndonjë procesi të pajtimit, veçanërisht nëse aplikohet modeli i besimit qytetar ku marrëdhëniet në mes të institucioneve dhe qytetarëve, dhe jo vetëm marrëdhëniet personale, konsiderohen vendimtare. Të gjithë kanë të drejtë të mos bashkëpunojnë, të mos takohen e të mos kontaktojnë, por preferimi për të qëndruar brenda një komuniteti të tjetrit duhet të respektohet. Për shembull, për shkak të gjuhëve të ndryshme, interesave tjera apo përvojave të kaluara.

## 5. Përfundimi

### 5.1. Përmirësim i kufizuar

Që nga viti 1999, pjesa veriore e Kosovës mbetet një zonë e konfliktit të pazgjidhur dhe të ngrirë ku në raste të ndryshme shpërthen dhuna. Përderisa territori formalisht është nën sovranitetin e Kosovës, faktikisht ai mbetet nën kontrollin e Serbisë. Zona në veri të lumit Ibër/Ibar është e mbipopulluar me serbë të Kosovës, që përbën vendbanimin kompakt më të madh dhe më të rëndësishëm të serbëve të Kosovës. Institucionet e themeluara serbe, përfshi themelimin e komunave paralele sipas ligjit të Serbisë në vitin 2008, që në këtë mënyrë shkelin Rezolutën 1244 të KS të OKB-së, janë mjete të rëndësishme për qeverinë e Beogradit për të ushtruar ndikim në Kosovë. Për serbët e Kosovës, këto institucione gjoja një garanci që mundëson mbetjen e tyre në Kosovë pa patur nevojë për tu integruar në sistemin e Kosovës i cili në masë të madhe refuzohet nga liderët e tyre politik radikalë dhe Beogradi. Mitrovicë/Mitrovica mbetet një qytet i ndarë, me pak komunikim përgjatë vijave. Vendosja e zyrtarëve doganorë të Kosovës më 25 korrik të vitit 2011 në dy pikat kufitare në veri të Kosovës nga autoritetet e Kosovës, nga liderët serbë politikë të Kosovës dhe nga Beogradi është parë si një përpjekje për të shtrirë dhe rforcuar sovranitetin e Kosovës në

<sup>118</sup> Intervistë me përfaqësues serb të Kosovës të OJQ-së, Mitrovicë/Mitrovica, 13 dhjetor 2011

<sup>119</sup> Intervistë me përfaqësues serb të Kosovës të OJQ-së, Mitrovicë/Mitrovica, 13 dhjetor 2011

<sup>120</sup> Intervistë me përfaqësues shqiptar të Kosovës të OJQ-së, Mitrovicë/Mitrovica, 13 dhjetor 2011

veri, veprim i cili ka nxitur protesta të serbëve të Kosovës kundër masave të tilla. Serbët e Kosovës nisën ngritjen e bllokadave rrugore dhe barrikadave.

Gjatë viteve të fundit, deri në ngritjen e barrikadave, marrëdhëniet ndëretnike dhe komunikimi në nivel lokal, janë përmirësuar. Njerëzit e kalonin urën në Mitrovicë/Mitrovica më lehtësisht, posaçërisht nga veriu në jug, tregtia në Lagjen e Boshnjakëve / Bošnjačka Mahala u rrit, për shembull. Edhe tani, njerëzit ndjehen më të sigurt dhe më rehat për tu takuar në vende të caktuara, siç janë restorantet, kafenetë, dhe jo në vetëm disa vende të cilësuar ‘neutrale’ si në fillim. Por situata aktuale politike shkon krejtësisht në anën e kundërt ndaj përpjekjeve të nivelit lokal për të përmirësuar edhe më tutje komunikimin ndëretnik dhe për ta bashkuar ndasinë.

Barrikadat e bën më të vështirë për njerëzit nga komunitete të ndryshme që të vazhdojnë të takohen. Jo vetëm për shkak të kufizimeve fizike, por edhe për shkak të presionit më të lartë përbrenda komuniteteve – në kohën e hulumtimit, ky presion ka qenë më i larti përbrenda komunitetit serb të Kosovës. Kushdo që i kalon barrikadat që janë ngritur dhe mbështeten nga ato qarqe që dëshirojnë të mbajnë pjesën veriore vetëm nën ndikimin e Serbisë, shkel ‘rregullin’ e pashkuar, po të fuqishëm, ‘të lojës’ për të mos bashkëpunuar, dhe duhet t’i frikësohet sanksioneve.

Spektori i shoqërisë civile, në veçanti ato të angazhuara në bashkëpunimin, pajtimin, ndërtimin e paqes dhe dialogun ndëretnik, në përgjithësi është i dobët. Disa pak organizata të fuqishme dhe disa pak persona shumë aktivë janë të mirënjohur – gjithashtu me donatorë dhe organizata ndërkombëtare në Kosovë. Kjo mban rrezikun se donatorët, agjencitë dhe aksionarët po përqendrohen në disa pak persona dhe organizata të dukshme, të marginalizojnë (potencialisht) të tjerët dhe ta lënë diskursin publik në një rreth përjashtues. Zërat dhe opinionet tjera mund të mbesin të padëgjuar. Për më tepër, kjo sjell edhe rrezikun se në rast se personi apo organizata, për çfarëdo arsyeje, largohet nga angazhimi, krijohet një vakuum dhe duhet të investohet kohë dhe resurse për ta mbushur atë<sup>121</sup>. Në mënyrë që të arrihet sa më shumë në shoqëri dhe të rritet ndikimi potencial që bashkëpunimi ndëretnik mund ta ketë në procesin e pajtimit, është qenësore që të përfshihen sa më shumë akterë që të jetë e mundshme, t’i adresohet sa më shumë shtresave të shoqërisë që të jetë e mundshme dhe të krijohet një bazë e gjerë.

## 5.2. Interesi reciprok si motivim

Kur kemi të bëjmë me ndërveprime në mes të komuniteteve të bazuar krejtësisht në interesin personal, siç është kërkimi për dokumente të Kosovës apo si në rastin e biznesit apo tregtisë, të përfshirë janë më shumë njerëz. Edhe pse të një natyre më sporadike – me përjashtim të biznesit të qëndrueshëm dhe afatgjatë –, këto kontakte vetë-iniciohen dhe mbështesin supozimin se një interes dhe benefit ekzistues reciprok mund të jetë mjaftë i fortë që të tërheqë njerëz nga komunitete të ndryshme dhe inkuzonë ata t’i ‘kalojnë vijat etnike’. Megjithatë, në kohëra me tensione të larta dhe me presion nga brenda-komuniteti, nevojitet guxim më i madh për të krijuar apo mbajtur kontaktet ndëretnike; interesi për që qëndruar në ‘anën e sigurt’ përbrenda komunitetit të njërit shpesh perceptohet më lartë sesa të bashkëpunosh dhe të shkelësh ‘rregullat e lojës’. Që nga ngritja e barrikadave, ato kontakte të vetë-iniciuara, bashkëpunimi në mes të afaristëve, por gjithashtu edhe tregtia në mes të pjesëtarëve të komuniteteve të ndryshme, kanë rënë dukshëm.

---

<sup>121</sup>Që nga fillimi i vitit 2011, dy aktivistë serbë të Kosovës nga një OJQ në veriun e Mitrovicës/Mitrovica janë arrestuar në Serbi për gjoja kontrabandë me armatim. Njëri ka qenë figurë e rëndësishme në veri të Mitrovicës/Mitrovica në lidhje me marrëdhëniet ndëretnike dhe është emëruar si “zyrtari favorit i ndërkombëtarëve në veri” nga mediet lokale. Shihni artikullin Aliu, Fatmir dhe Barlovac, Bojana: Policia serbe arreston dy serbë të Kosovës staff i BE-së. BalkanInsight, 18 nëntor 2011; <http://www.balkaninsight.com/en/article/momcilo-arlov-arrested-in-serbia>

Ndjenja e, në veçanti popullatës së re, se ‘nuk ka asgjë në anën tjetër’, se asgjë nuk ekziston në veri/jug të lumit Ibër/Ibar për të cilën do t’ia vlente të kalohej ura, është një tregues se sa e ndarë është shoqëria dhe se sa shumë secili prej komuniteteve kanë krijuar një zonë të veten brenda së cilës mund të lëvizin lirshëm. Rëndësia e lokacionit ‘të duhur’ për bashkëpunim ndëretnik, ku të gjitha komunitetet e interesuara ndjehen rehat dhe të sigurt, nuk duhet të nënvlerësohet.

### **5.3. Marrëdhëniet personale – jo politikës**

Përqendrimi kryesor i aktiviteteve lokale në bashkëpunimin ndëretnik është, së paku për momentin, në krijimin e marrëdhënieve, bashkimin e njerëzve dhe komuniteteve. Marrëdhëniet janë krijuar në sferën e ndërlidhur me punën, në mesin e kolegëve, dhe në sferën e ndërlidhur me projektin, në mesin e pjesëmarrësve. Tregtia, biznesi dhe punësimi shihen si çështjet kryesore në krijimin e marrëdhënieve dhe në ushqimin e bashkëpunimit ndëretnik. Në të dy sektorët, bizneset dhe OJQ-të, disa marrëdhënie të ndërlidhura me punën/projektin/biznesin janë transformuar në marrëdhënie personale dhe/apo shoqëri. Marrëdhëniet e krijuara kanë arritur nivel privat, por nuk mund të thuhet se kanë patur ndikim në sferën publike, ndikim në shoqëri dhe në politikë.

Përfaqësuesit e OJQ-ve dhe bizneseve janë shumë të kujdesshëm për të mbajtur politikën, dhe çdo diskutim për të, jashtë zonës së tyre. ‘Ne nuk merremi me politikë’ është përsëritur si një mantra nga të gjithë të intervistuarit. Të gjithë ata mbështesin një politikë ‘pa politikë’ si një mekanizëm për të qenë në gjendje të bashkëpunohet pavarësisht mendimeve të mundshme të ndryshme apo kundërshtuese (politike). Në vend të kësaj, ata përqendrohen në çështje të përbashkëta, zgjidhjen e problemeve praktike, dhe të arrijnë një bashkëpunim të mirë ndëretnik. Të dy, si sektori afarist ashtu edhe ai shoqëror, janë deklaruar se nuk janë në gjendje të ndikojnë në nivelin politik. Mundësitë e tyre janë shumë të limituara nga ndikimi i përgjithshëm politik. Për momentin, krijimi dhe ruajtja e marrëdhënieve mund të jetë gjëja e vetme që mund ta arrijnë.

### **5.4. Nga marrëdhënia në besim qytetar**

Krijimi i marrëdhënieve direkte është një hap shumë i rëndësishëm për të ndëruar besimin në mes të njerëzve. Por ky hap duhet vërtet të përfshijë të gjithë për të rikthyer besimin përbrenda një shoqërie vetëm përmes marrëdhënieve personale. Kjo jo vetëm se qartë do të ishte e pamundshme, por të gjithë kanë të drejtë të mos bashkëpunojnë, të mos takohen apo kontraktjnë, por të preferojnë të qëndrojnë brenda komunitetit të vet. Për shkak të gjuhëve të ndryshme, për shembull, interesave tjera apo përvojave të kaluara. Mos-dashja e krijimit të marrëdhënieve direkte me pjesëtarët e komuniteteve tjera nuk do të thotë se kjo gjë automatikisht rrezikon ndonjë proces pajtimi në kuptimin e modelit të besimit qytetar.

Modeli i besimi qytetar vë thekson jo aq shumë tek marrëdhëniet direkte, por në besimin në mes të pjesëtarëve të komuniteteve të ndryshme, në mes të qytetarëve, në mes të institucioneve dhe qytetarëve bazuar në vlerat dhe normat e përbashkëta dhe në njohurinë që ata janë të detyruar respektivisht se shkelja e atyre normave të përbashkëta sanksionohet nga institucionet.

Për të krijuar besimin qytetar, OJQ-të do të duhej të bashkëpunonin në strukturat, në sundimin e ligjit, qeverisjen e mirë, të drejtat e njeriut, të merren me të kaluarën, korrupsionin etj.. Deri më tani, këto tema nuk janë përqendrim kyç i shoqërisë civile në Mitrovicë/Mitrovica dhe në veriun e Kosovës. Pjesa e ndërlidhur për momentin është: përderisa Beogradi dhe Prishtina garojnë me njëri-tjetrin se kush po ushtron kontroll ndaj pjesës veriore të Kosovës, se cilat institucione janë ‘ato të vërtetat’, është e pamundshme të krijohet besimi në mes të qytetarëve dhe institucioneve garuese. Ajo për çka ka nevojë është një kornizë politike dhe stabilitet. Zgjidhja e situatës politike nuk do të sillte stabilitet vetëm për të tashmen, por do të ofronte perspektivë dhe një vizion të përbashkët për të ardhmen,

të cilin Lederach e quan si kusht për çdo proces të pajtimit. “Nëse nuk e dimë se ku jemi duke shkuar, është vështirë të arrihet atje”.<sup>122</sup>

### 5.5. Çështjet e paadresuara nga e kaluara

E ardhmja është vetëm një drejtim në të cilin duhet shkuar. S’mund të krijohet besimi qytetar nëse nuk përballemi me të kaluarën, nuk iu adresohemi shkeljeve të të drejtave të njeriut, nëse nuk njihen vuajtjet e ‘tjetrit’, dhe nëse nuk merren masa për të rikthyer sundimi i ligjit si dhe të merren masa për të garantuar mos-përsëritjen si disa shembuj. Përballja me të kaluarën si element qendror në procesin e pajtimit është ende temë tabu në Kosovë<sup>123</sup>, veçanërisht të flitet për krimet e kryera nga pjesëtarët e komunitetit të vet dhe pranimiti i pjesëtarëve të komunitetit “tjetër” si viktimë<sup>124</sup>. Drejtësia tranzicionale dhe sjellja e përgjegjësve të krimeve para drejtësisë është parë si një parakusht për krijimin e marrëdhënieve ndëretnike nga disa të intervistuarit<sup>125</sup>. Deri më tani, kjo çështje nuk adresohet në Mitrovicë/Mitrovica dhe në pjesën veriore të Kosovës, dhe shumë pak organizata punojnë në këtë në Kosovë. Përsëri, kjo gjë nuk mund të jetë detyrë vetëm e organizatave lokale. Kjo është më shumë detyrë e institucioneve për tu përfshirë në drejtësinë tranzicionale, të rikthejnë sundimin e ligjit dhe të garantojnë mos-përsëritjen. Nevoja për një qasje plotësuese nga lartë-poshtë është përmendur edhe nga disa partnerë të të intervistuarve si kusht qenësor për përmirësimin e marrëdhënieve në mes të komuniteteve të ndryshme<sup>126</sup>.

Edhe kthimi është një çështje e pazgjidhur e cila ka nevojë për t’ju adresuar. Shumica dërmuese e të gjithë PZhB-ve në Kosovë jetojnë në Mitrovicë/Mitrovica dhe në pjesën veriore të Kosovës. Shumë jo-serbë që kanë jetuar në pjesën veriore para qershorit të vitit 1999 tani janë në pjesën jugore të Mitrovicës/Mitrovica, ndërsa serbët nga jugu i Mitrovicës/Mitrovica apo pjesë tjerë të Kosovës, plus një numër i vogël i refugjatëve nga Kroacia dhe Bosnja e Hercegovina jetojnë në pjesën veriore.

### 5.6. Qasja multidimensionale

Organizatave të shoqërisë civile zbatohen shumë llojshmëri të aktiviteteve, dhe kanë krijuar mënyra të ndryshme të operimit: si organizata multi-etnike apo mono-etnike bashkërisht zbatojnë një projekt me organizata tjera. Tjerat janë organizata multi-etnike me dy zyra, të targetojnë komunitete të ndryshme ndaras, por që krijojnë kontakte aty ku është e mundshme. Disa prej tyre përqendrohen krejtësisht vetëm në një komunitet, e që synojnë në fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile, në hapjen e mundësive për (kryesisht popullatës së re), në nxitjen e tolerancës dhe diversitetit të mendimeve. Jo çdo projekt i bashkëpunimit ndëretnik është vetvetiu i vlefshëm dhe kontribut drejtë pajtimit. Në mënyrë që të nxitet toleranca, mendje-hapja, të drejtat e njeriut, krijimi i hapësirës për zhvillimin dhe shprehjen e mendimeve të ndryshme, etj., mund të jetë e dobishme që t’i adresohet vetëm një komuniteti dhe në këtë mënyrë të arrihet një rreth më i gjerë i pjesëmarrësve, respektivisht pjesëmarrësve tjerë siç do të ishte në këtë rast me projekte ndëretnike. Sikurse që bashkëpunimi ndëretnik do të duhej të bazohej në vullnetarë dhe në interesa të përbashkëta, edhe mos-bashkëpunimi është një opsion legjitim.

<sup>122</sup>Lederach 2008, f. 77

\* Intervistë me përfaqësues serb të Kosovës të OJQ-së, Mitrovicë/Mitrovica, 28 tetor 2011

<sup>123</sup>Shihni gjithashtu artikullin në BalkanInsight nga Elira Çanga, 16 nëntor 2011

<sup>124</sup>Instituti për Hulumtimin e Krimeve të Luftës, i cili ishte themeluar nga qeveria e Kosovës qershorin e vitit 2011 do t’i ekzaminojë të gjitha krimet e kryera deri në hyrjen e forcave të NATO-s në Kosovë qershorin e vitit 1999, por jo ato të kryera kryesisht kundër jo-shqiptarëve pas konfliktit të vitit 1998/99. Shih: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet\\_e\\_mbledhjes\\_se\\_19-te\\_te\\_Qeverise\\_2011.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_mbledhjes_se_19-te_te_Qeverise_2011.pdf);

<sup>125</sup> Intervistë me përfaqësuesin e OJQ-së me qendër në Mitrovicë/Mitrovica veriore, 19 tetor 2011

<sup>126</sup> Intervistë me përfaqësues serb të Kosovës të OJQ-së në Mitrovicë/Mitrovica, 28 tetor 2011



Përcjellja e qasjeve të ndryshme dhe zbatimi i aktiviteteve të ndryshme nuk do duhej të çonte në një garë rreth rrugës së 'drejtë' dhe 'të gabuar' ndaj bashkëpunimit dhe pajtimit ndëretnik. Përkundrazi, qasjet e ndryshme do të mund të zhvillonin efekte sinergjike, mund të përfshijnë pjesëmarrës më të shumtë dhe më të ndryshëm. Me kusht që të jetë një synim i përbashkët. Pajtimi është një proces shumë kompleks, multidimensional dhe multinivelësh në të cilin qasje e ndryshme plotësuese duhet të konsiderohet si pasurim.

## **6. Rekomandimet**

### **Institucioneve (ndërkombëtare, kombëtare dhe lokale):**

- të aplikojnë një qasje përfshirëse, të akomodojnë nevoja specifike dhe llogari për ndjeshmërinë e pjesëtarëve të të gjitha komuniteteve – p.sh. të ofrojnë shërbime në gjuhët që fliten nga komunitetet, të ofrojnë shërbime në lokacione ku mund të qasen lehtë nga komunitetet, të jetë të vetëdijshëm dhe tu shmangen, kudo që të jetë e nevojshme, simboleve, termeve, formulimeve që mund të nxisin fyerje dhe që perceptohen negativisht përbrenda komuniteteve të ndryshme
- t'i de-politizojnë problemet dhe të përqendrohen në zgjidhjen konstruktive të problemit
- t'i njohin aftësitë e gjuhës (gjuhët e folura nga komunitetet në Kosovë) si aset vendimtar në procesin e punësimit dhe promovimit
- ta zbatojnë sundimin e ligjit në përdorimin e gjuhëve zyrtare si pasojë
- të zhvillojnë një strategji për tu marrë me çështjet e kthimit dhe të pronave
- të përfshihen në dialog me qytetarët, posaçërisht me komunitetet, bizneset dhe me shoqërinë civile
- të zhvillojnë dhe zbatojnë një strategji gjithëpërfshirëse për tu përballur me të kaluarën dhe me drejtësinë tranzicionale të bazuar në respekt për të gjitha viktimat dhe të bazuar në përgjegjësinë individuale
- të futë stimuj mbështetës: mbështetje (financiare/materiale) për punësim të pjesëtarëve të komunitetit jo-shumicë në kompani private, kudo që është e mundshme; një përqindje e caktuar e pozitave mund të bashkë-financohet si kompensim për kosto të mundshme më të larta (administrative) të cilat shfaqen, p.sh.përmes përdorimit të disa gjuhëve, provizionit të transportit, etj..
- të mbështesin investimet/bizneset në zona të përziera dhe/ose në zona afër zonave të përziera lehtë të qasshme nga pjesëtarët e të gjitha komuniteteve; p.sh. krijimi i parkut biznesor me normë të ulët të tatimit, provizione në infrastrukturë, që fokusohet kryesisht në biznese që krijojnë/akomodojnë kërkesën dhe/ose krijojnë vende pune për pjesëtarët e komuniteteve të ndryshme
- të jenë transparentë, të zbatojnë sundimin e ligjit në të gjithë sektorët për të krijuar besimin qytetar në mes të qytetarëve dhe institucioneve

### **Institucioneve (ndërkombëtare, kombëtare dhe lokale) dhe donatorëve:**

- të mbështesin mësimin e gjuhëve të folura nga komunitetet në Kosovë pasi që aftësitë gjuhësore janë aset qenësor në komunikimin ndëretnik
- të aplikojnë një qasje pragmatike, të jenë fleksibël për t'ju përshtatur programeve/projekteve/qasjeve me shpejtësi nëse kërkohet
- të zhvillojnë dhe zbatojnë një strategji gjithëpërfshirëse për të stimuluar prodhimin lokal; ofrojnë stimulim fillestar dhe mbështetje për profesionalizim

### **Donatorëve:**

- të lehtësojnë kontaktet në mes të bizneseve, mbështesin krijimin e bashkëpunimit, p.sh. përmes panairëve, të ofrojnë informata dhe qasje në panairë, informata
- të jenë transparentë në lidhje me synimet e veta dhe strategjinë; të ndërtojnë marrëdhëniet të besueshme me partnerët zbatues
- të mos përqendrohen në vetëm disa akterë të cilët njihen përgjithësisht; t'i identifikojnë disa liderë (të mundshëm) politikë, aktivistë dhe organizata, të përfshihen në ndërtimin e kapaciteteve dhe në forcimin e resurseve për të zgjeruar bazën e organizatave dhe personave të përfshirë, të nxisin diversitetin dhe në këtë mënyrë të arrijnë më shumë pjesëmarrës dhe sektorë të shoqërisë

### **Donatorëve dhe OJQ-ve:**

- të zhvillojnë një strategji afatgjate dhe të përfshihen në projekte afatgjate; aktivitetet afatshkurta dhe të vetme duhet të përcillen dhe të integrohen në një strategji kryesore në mënyrë që të sigurojnë qëndrueshmëri
- të forcojnë punën brenda-komunitetit për t'i rritur kapacitetet dhe resurset përbrenda komuniteteve, t'i arrijnë pjesëmarrësit e mundshëm të cilët nuk do të përfshihen në bashkëpunimin ndëretnik (menjëherë) – ata që 'arrihen vështirë' -, dhe të rrisin tolerancën dhe diversitetin përbrenda komuniteteve
- të përfshihen në zonat 'mono-etnike' edhe me projekte brenda-komunitetit
- të zgjedhojnë bazën e njerëzve të përfshirë në aktivitete: t'i adresohen një diversiteti të grupeve të targetuara, përfshi të gjithë sektorët e shoqërisë, p.sh. gratë, fëmijët, të rinjtë, të papunët, intelektualët, pensionistët
- të mbështesin iniciativa/aktivitete në zona të përziera ku funksionon bashkëjetesa edhe nëse duket si 'super e lirshme' në shikim të parë pasi që njerëzit tanimë takohen në shtëpi, në rrugë, në dyqane, pa probleme; por të ofrohet një hapësirë (më) publike dhe të institucionalizohen marrëdhëniet ndëretnike, të lehtësohen diskutimet, bërja e hapësirës së takimit më e qasshme për pjesëtarët e të gjitha komuniteteve që jetojnë në atë zonë, do të ketë një efekt stabilizues, do të përmirësojë besimin qytetar dhe do t'i forcojë aftësitë për tu ballafaquar me konfliktet dhe në situata delikate
- të zbatojnë projekte dhe aktivitete të bazuara në nevojat dhe çështjet e interesit – dhe jo për hir të zbatimit vetëm të projekteve ndëretnike

### **OJQ-ve:**

- të themelojnë një rrjet/platformë (formale apo joformale) të të gjitha OJQ-ve dhe iniciativave të përfshira në bashkëpunimin ndëretnik, në punën brenda komunitetit, në ndërtimin e paqes, në të drejtat e njeriut, në media, në çështjet e komunitetit për të zhvilluar një synim dhe plan të përbashkët strategjikisht për zonën; të shkëmbejnë informata, të koordinojnë aktivitetet për të shtuar sinergjinë, të zbatojnë projekte të përbashkëta ku një organizatë e vetme mund të mos jetë në gjendje ta bëjë; ky rrjet/platformë duhet të lobojë tek institucionet, donatorët, publiku i gjerë; duhet gjithashtu të zhvillojë një politikë të përbashkët avokuese ndaj institucioneve dhe nivelit politik për ta forcuar ndikimin e sektorit të shoqërisë civile
- të vlerësojnë në mënyrë kritike dhe t'i vlerësojnë programet dhe projektet në lidhje me qëndrueshmërinë dhe ndikimin e tyre
- t'i identifikojnë 'hapësirat e përbashkëta' të cilat janë të qasshme për pjesëtarët e komuniteteve të ndryshme për takime/aktivitete; të tentojnë të zgjerojnë 'hapësirat e

përbashkëta', respektivisht, ta rrisin ndjenjën e sigurisë për pjesëtarët e komuniteteve të ndryshme

- t'i identifikojnë zonat potenciale të angazhimit dhe/ose të bashkëpunojnë me organizata tjera (lokale/kombëtare/zonëale) që u adresohen çështjeve siç janë Ballafaqimi me të Kaluarën, asistencë në kthim, të drejtat e njeriut
- nëse aplikohet qasja e dy-zyrave apo ajo e brenda-komunitetit, të zhvillohet një strategji që nuk manifeston ndasi etnike në periudhë afatgjatë

#### **Bizneseve:**

- të jenë të vetëdijshëm të rolit pozitiv që biznesi mund ta luaj për të nxitur kontaktet dhe bashkëpunimin ndëretnik; të promovojë këtë rol dhe ta aplikojë një qasje përfshirëse; të arrijë dhe të ofrojë shërbime ndaj pjesëtarëve të të gjitha komuniteteve
- të krijojë rrjet (formal/joformal) për ta forcuar pozitën e biznesit për të punuar 'përgjatë vijave etnike', t'i inkurajojë tjerët me shembuj të mirë, dhe të ndikojë tek 'rregullat e lojës'

#### **Medieve:**

- të krijojnë rrjete, bashkëpunim joformal apo formal me gazetarët nga komunitetet tjera, të shkëmbejnë informata, të mbështesin në mënyrë që të marrin informata të vlefshme nga anë të ndryshme
- të thyejnë rregullën se "vetëm lajmet e këqija janë lajme të mira", të japin shembuj të mirë, të përqendrohen në çështjet e përbashkëta dhe në brengat e përbashkëta
- të jenë të vetëdijshëm për përgjegjësinë e lartë për krijimin e paragjytimeve – dhe mbrapsht, për shuarjen e paragjytimeve duke u angazhuar në raportim objektiv, dhe të aplikojnë një qasje dhe një gjuhë të ndjeshme dhe jo-diskriminuese
- të ofrojnë hapësirë dhe mundësi për të shprehur dhe diskutuar mendime të ndryshme,, edhe çështjet më me presion të kohës, t'i ftojnë anëtarët e të gjitha komuniteteve të marrin pjesë
- të hulumtojnë mundësitë e aktiviteteve të medieve të përbashkëta siç është (bashkë-)produksioni i emisioneve të përbashkëta, gazeta, revista; t'i bëjnë mediet e veta më atraktive për pjesëtarët e komuniteteve tjera duke, p.sh. titruar emisionet biseduese, emisionet politike

## **Burimet**

Statistikat, Raportet, Hulumtimet (Mitrovicë, Kosovë)

Collaborative Learning Projects (CDA): Has Peacebuilding Made a Difference in Kosovo? A Study of the Effectiveness of Peacebuilding in Preventing Violence: Lessons Learned from the March 2004 Riots in Kosovo. Prishtina, 2006; <http://careks.org/pub3.pdf>

European Centre for Minority Issues Kosovo: The EthnoPolitical Map of Kosovo. Online publication; [http://www.ecmi-map.com/map/index.php?option=com\\_content&view=category&layout=blog&id=3&Itemid=2&lang=en](http://www.ecmi-map.com/map/index.php?option=com_content&view=category&layout=blog&id=3&Itemid=2&lang=en)

European Stability Initiative (ESI): People or territory? A proposal for Mitrovica. Berlin, Brussels, Sarajevo, 16 February 2004; [http://www.esiweb.org/pdf/esi\\_document\\_id\\_50.pdf](http://www.esiweb.org/pdf/esi_document_id_50.pdf)

Haener, Olivier: Un Kosovo unitaire divisé : les politiques des acteurs locaux et internationaux au Nord du Kosovo à la lumière de la division de la région de Mitrovica; Politorbis Nr. 51 1/2011; Bern : Federal Department of Foreign Affairs FDFA; 2011; <http://www.eda.admin.ch/politorbis>

Inicijativa Kosovare për Stabilitet / Kosovar Stability Initiative (IKS): Mitrovica: One City, Two Realities. Policy Briefs. Pristina, 17 December 2009; [http://iksweb.org/Photos/Publikimet/Images/Mitrovica\\_\\_Dy\\_Realitete,\\_Nj%C3%AB\\_Qytet/enMitrovica\\_one\\_city,\\_two\\_realities\\_6\\_Briefs\\_FINAL\\_with\\_cover.pdf](http://iksweb.org/Photos/Publikimet/Images/Mitrovica__Dy_Realitete,_Nj%C3%AB_Qytet/enMitrovica_one_city,_two_realities_6_Briefs_FINAL_with_cover.pdf)

International Crisis Group (ICG): North Kosovo: Dual Sovereignty in Practice. Europe Report No. 211; 14 March 2011; [http://www.crisisgroup.org/~media/Files/europe/balkans/kosovo/211%20North%20Kosovo%20---%20Dual%20Sovereignty%20in%20Practice.pdf](http://www.crisisgroup.org/~/media/Files/europe/balkans/kosovo/211%20North%20Kosovo%20---%20Dual%20Sovereignty%20in%20Practice.pdf)

Organization for Security and Co-operation in Europe (OSCE) Mission in Kosovo: Kosovo Communities Profiles 2010. Pristina, February 2011; <http://www.osce.org/kosovo/75450>

Organization for Security and Co-operation in Europe (OSCE) Mission in Kosovo: Municipal Profiles 2009; <http://www.osce.org/kosovo/43753>

Palaret, Michael: Trepça, 1965 – 2000. A report to LLA/ESI; Lessons Learned and Analysis Unit of the EU Pillar of UNMIK in Kosovo/European Stability Initiative, 11 June 2003; [http://www.esiweb.org/pdf/esi\\_document\\_id\\_62.pdf](http://www.esiweb.org/pdf/esi_document_id_62.pdf)

United Nations Development Programme (UNDP): Mitrovicë/a Public Opinion Survey. Pristina, March 2011; [www.kosovo.undp.org/repository/docs/Final-ENG-Mitrovica-Opinion-Poll.pdf](http://www.kosovo.undp.org/repository/docs/Final-ENG-Mitrovica-Opinion-Poll.pdf)

United Nations High Commissioner for Refugees (UNHCR) Office of the Chief of Mission, Pristina, Kosovo: Statistical Overview. Update at end February 2011; [http://www.internal-displacement.org/8025708F004CE90B/%28httpDocuments%29/BB679BDE71F17429C125785C005FEC76/\\$file/Statistical+overview+February+11.pdf](http://www.internal-displacement.org/8025708F004CE90B/%28httpDocuments%29/BB679BDE71F17429C125785C005FEC76/$file/Statistical+overview+February+11.pdf)

World Bank / Statistical Office of Kosovo: Kosovo Poverty Assessment. Volume I: Accelerating Inclusive Growth to Reduce Widespread Poverty. 03. October 2007; <http://web.worldbank.org/WBSITE/EXTERNAL/COUNTRIES/ECAEXT/KOSOV>

OEXTN/0,,contentMDK:21761784~menuPK:297788~pagePK:64027988~piPK:64027986~theSitePK:297770~isCURL:Y,00.html

World Bank / Statistical Office of Kosovo: Consumption Poverty in the Republic of Kosovo in 2009. Western Balkans Programmatic Poverty Assessment. May 2011; [http://siteresources.worldbank.org/INTKOSOVO/Resources/Kosovo\\_Poverty\\_for\\_web\\_eng.pdf](http://siteresources.worldbank.org/INTKOSOVO/Resources/Kosovo_Poverty_for_web_eng.pdf)

### **Artikujt, punime për diskutim (Pajtim, ndërtim i paqes)**

Bloomfield, David: On Good Terms: Clarifying Reconciliation. Berghof Report No. 14; Berghof Research Center for Constructive Conflict Management; Berlin, 2006; <http://www.berghof-conflictresearch.org/documents/publications/br14e.pdf>

De Greiff, Pablo: The Role of Apologies in National Reconciliation Processes: On Making Trustworthy Institutions Trusted. In: Gibney, Mark, et.al. (eds): The Age of Apologies. University of Pennsylvania Press, Philadelphia, 2008; p.120 – 136

Fischer, Martina: Transitional Justice and Reconciliation: Theory and Practice. Berghof Handbook; Berghof Center for Constructive Conflict Management; Berlin, 2011 - [http://www.berghof-handbook.net/documents/publications/fischer\\_tj\\_and\\_rec\\_handbook.pdf](http://www.berghof-handbook.net/documents/publications/fischer_tj_and_rec_handbook.pdf)

Franović, Ivana: Dealing with the Past in the Context of Ethnonationalism. The Case of Bosnia-Herzegovina, Croatia and Serbia. Berghof Occasional Paper Nr.29; Berghof Research Center for Constructive Conflict Management; Berlin, October 2008; <http://www.berghof-conflictresearch.org/documents/publications/boc29e.pdf>

Lederach, John Paul: Building Peace. Sustainable Reconciliation in Divided Societies. United States Institute of Peace Press, Washington, 2008 (8)

### **Partnerët e intervistave në renditje alfabetike disa persona kanë kërkuar të mbesin anonim**

Afërdita Syla, Community Building Mitrovica (CBM), OJQ, Mitrovicë

Çerkin Veseli, Zyra e Komunës për Komunitete (ZKK), Zubin Potok

Dejan Radivojević, United Nations Development Programme (UNDP), Prishtinë

Dušan Radaković, aktivist i shoqërisë civile, Mitrovicë

Erol Zekiria, Zyra e Komunës për Komunitete (ZKK), Mitrovicë

Fisnik Kumnova, m-magazine, Mitrovicë

Florin Peci, konsulent biznesor, Mitrovicë

Haki Imeri, Zyra e Komunës për Komunitete (ZKK), Leposaviq

Hasime Tahiri, Mundësia (MDA), OJQ, Mitrovicë

Lulzim Hoti, 7Arte, OJQ, Mitrovicë

Nedžat Ugljanin, përfaqësues i komunitetit boshnjak për Mitrovicë

Nevenka Medić, Qendra për Zhvillim të Komuniteteve/Centar za razvoj zajednice, OJQ, Mitrovicë

Olivera Milošević, Asociacioni i Grave për Biznes, OJQ, Mitrovicë

Skender Idrizi, vi-print, Mitrovicë

Sokol Kuršumlija, Association for Peace Kosov@ (AFPK), OJQ, Mitrovicë

Tatjana Lazarević, Qendra për Zhvillim të Komuniteteve/Centar za razvoj zajednice, OJQ, Mitrovicë